



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 60, datë 31.01.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-2016 GJATË USHTRIMIT TË
DETYRËS SË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë” dhe nr. 193, datë 12.05.2021, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i hartuar nga relatores znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJITRATIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të njohurive dhe arsyetimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit, bazuar në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij, relacionet/opinionet ligjore të përgatitur prej tij për çështjet e përzgjedhura me short dhe burimet e tjera të vlerësimit. Aftësia profesionale e ndihmësmagjistratit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “{...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtarja, përgjithësisht, përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, parimin e disponibilitetit të padisë. Përrjashtimisht është evidentuar si e vetmja mangësi ligjore në dosjen nr. 2, ku është konkluduar se: “Konstatohet se propozimi i ndihmësligjorit {...} për mënyrën e zgjidhjes së çështjes nuk përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar dhe vendosur ndryshe nga sa është propozuar nga subjekti i rivlerësimit”. Për t’u vlerësuar gjithashtu është fakti që gjyqtare {...} në vendimet e dhëna prej saj, kur është rasti, përdor referenca nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, etj. Së fundi, ndër tri vendimet gjyqësore të vëzhguara, dy prej tyre nuk kanë rezultuar të cenuara nga Gjykata e Apelit apo nga Gjykata e Lartë. Subjekti i rivlerësimit {...}, në cilësinë e gjyqtares, ka

shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Në cilësinë e ndihmësligjorit në Gjykatën e Lartë evidentohen cilësi të mira në arsyetimin ligjor në 6 relacionet e vëzhguara. Në lidhje me detyrën e ndihmësligjorit të kryer nga znj. {...} në Gjykatën e Lartë, në aktvlerësimet e kësaj të fundit, kryer për periudhat 2014 - 2015 dhe prill 2015 - prill 2016, evidentohet fakti se subjekti i rivlerësimit jep mendime të argumentuara ligjërisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Znj. {...} është vlerësuar nga Gjykata e Lartë se është e aftë të shkruajë thjesht dhe qartë projektvendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë.”

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësligjorit nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- *Në lidhje me përcaktimin dhe renditjen e rrethanave të çështjes:*

Në 12 dokumentet ligjore burim vlerësimi, faktet e çështjes janë renditur në pjesën e parë të relacionit, nën titullin “Rrethanat e çështjes”, duke u pasqyruar në mënyrë të plotë, të qartë dhe të përmbledhur duke u ndërthurur në mënyrë logjike me provat e administruara në dosje, mbi bazën e së cilave fakti penal është ndërtuar apo ka lindur apo mbi bazën e të cilës ka lindur, është krijuar marrëdhënie juridike civile, tregtare apo e punës mbi bazën e të cilës është zhvilluar mosmarrëveshja civile. Spikat aftësia e ndihmësmagjistrates për t’i përmbledhur dhe parashtruar faktet e çështjes në mënyrë të thjeshtë, koncize dhe lehtësisht të kuptueshme, duke evidentuar elementet thelbësore që lidhen me faktin penal objekt gjykimi, elementë të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, autorin e veprës penale, marrëdhënien civile objekt konflikti, marrëdhënies mes paditësit dhe të paditurit dhe arsytet e lindjes së mosmarrëveshjes mes tyre, konfliktin civil dhe zgjidhja në gjykatë.

- *Në lidhje me evidentimin e ecurisë procedurale të çështjes:*

Në drejtim të evidentimit të ecurisë procedurale të çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, menjëherë pas paraqitjes në mënyrë të përmbledhur dhe koncize të fakteve thelbësore të çështjes, gjithmonë të integruar me provat e marra në shqyrtim, rezulton të jetë evidentuar dhe pasqyruar në mënyrë të qartë qëndrimi i gjykatave të faktit duke pasqyruar dispozitivin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit si dhe një pjesë e arsyetimit të vendimeve të gjykatave. Pjesët thelbësore të arsyetimit të vendimit të gjykatave të faktit përqendrohen kryesisht në raport me shkaqet e rekursit, duke mos cituar pjesë të panevojshme të tyre, të cilat nuk janë objekt kontestimi nga palët nëpërmjet rekursit të ushtruar. Megjithatë në disa raste ato paraqite në mënyrë të detajuar duke dhënë një panoramë të qartë të marrëdhënies juridike objekt

konflikti, sidomos në çështjet që ndihmësmagjistratia ka ngritur çështje të cilat ajo mendon se duhet të diskutohen nga gjyqtarët në dhomë këshillimi.

Ndihmësmagjistratja, përgjithësisht në një strukturë të qëndrueshme, evidenton në çdo rast qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë duke pasqyruar në fillim dispozitivin e vendimit dhe më pas argumentimin ligjor që bën Gjykata. Më pas vazhdon me pasqyrimin e dispozitivit të Gjykatës së Apelit dhe argumentimin e saj ligjor. Një strukturë tjetër e përdorur nga ndihmësja është edhe ajo e pasqyrimin fillimisht të dispozitivëve/ vendimmarrjen e gjykatave të faktit dhe më pas argumentimin e tyre ligjor. Në këto raste, fill pas pasqyrimin të dispozitivëve listohen shkaqet e rekursit. Në disa relacione mungon arsyetimi ligjor i Gjykatës së Shkallës së Parë¹, kur shkaqet e rekursit nuk lidhen me arsyetimin e gjykatave dhe në disa të tjerë mungon arsyetimi ligjor i të dyja gjykatave të faktit².

Në një ose disa paragrafë, në mënyrë të përmbledhur, paraqitet pjesa thelbësore e arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen, duke i kushtuar rendësi pasqyrimin të atyre pjesëve të arsyetimit që lidhen drejtpërdrejtë me elementët e veprës penale, provueshmërinë e tyre dhe të autorësisë së veprës, kushtet dhe kriteret për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim³, cënimin ose jo të rezervës ligjore në hartimin e një testamenti⁴ etj. Në çështjet në të cilat shkaqet e rekursit konsistojnë në elementë të procedurës, ndihmësmagjistratja pasqyron ato pjesë të arsyetimit që lidhen drejtpërdrejt me shkaqet e rekursit, pa u ndalur në citimin e pjesëve të vendimit në lidhje me themelin e çështjes, të cilat nuk janë kontestuar nga palët.

Më pas pasqyrohet dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit, duke vijuar me pasqyrimin e pjesëve thelbësore të arsyetimit, veçanërisht në rastet kur qëndrimi i Gjykatës së Apelit ndryshon nga ai i gjykatës së shkallës së parë në drejtim të legjitimitetit të paditësit për të ngritur padi⁵, analizën e provave të administruar për efekt të vlerësimit të kriterëve ligjore të aplikimit të dënimeve alternative⁶, paqartësinë e paditësit në kërkimet e tij⁷. Në rastet kur qëndrimi i gjykatës së apelit është i njëjtë me atë të shkallës së parë, ndihmësmagjistratja ka paraqitur pjesët kryesore të arsyetimit të vendimit të gjykatës, duke evidentuar kryesisht ato pjesë të arsyetimit që lidhen me shkaqet e apelit⁸. Në shumicën e rastet kur qëndrimi i të dy gjykatave është i njëjtë, rezulton kujdesi për të pasqyruar qëndrimin e gjykatës së apelit në lidhje me pretendime të cilat janë ngritur për vlerësim para saj, sikurse është rasti i pasqyrimin të qëndrimin të gjykatës së apelit në lidhje individualizimin e llojit dhe masës së dënimit duke u bazuar në rrethanat e kryerjes së veprës penale⁹.

¹ Relacion për çështjen civile nr.23000-01017-00-2013; Relacion për çështjen civile nr.11117-02810-002013; Relacion për çështjen civile nr.31003-03561-00-2013; Relacion për çështjen civile nr.11243-00225-00-2013.

² Relacion për çështjen penale nr. 56430-01087-00-2012; Relacion për çështjen penale nr.52303-01532-00-2012; Relacion për çështjen civile nr.11241-01619-00-2013.

³ Relacion për çështjen penale nr.56250-00893-00-2013.

⁴ Relacion për çështjen civile me nr. 11243-03063-00-2013

⁵ Relacion për çështjen civile me nr. 11243-02530-00-2012.

⁶ Relacion për çështjen penale nr.56250-00893-00-2013

⁷ Relacion për çështjen civile me nr 11118-02240-00-2013

⁸ Relacion për çështjen civile me nr. 11117-02810-00-2013

⁹ Relacion për çështjen penale me nr. 56250-00893-00-2013

Në tërësi, sa i përket pasqyrimin të ecurisë procedurale të çështjeve, si një element thelbësor për ta bërë të kuptueshme por edhe të qartë natyrën e çështjes së shtuar për zgjidhje para Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë, rezultojnë kujdesi i ndihmësmagjistrates për të pasqyruar qartë dhe me saktësi ecurinë procedurale të çështjeve.

- *Në lidhje me shkaqet e rekursit/kërkesës drejtuar Gjykatës së Lartë:*

Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, shkaqet e rekursit/kërkesës drejtuar Gjykatës së Lartë, paraqiten në një pjesë me vete të relacionit të titulluar “rekursi”, menjëherë pas paraqitjes së ecurisë procedurale të çështjes dhe qëndrimit të gjykatave të faktit.

Në pasqyrimin e shkaqeve të rekursit, pas evidentimit të palës që ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe ka investuar Gjykatën e Lartë, ndihmësmagjistratja paraqet në mënyrë koncize dhe të përmbledhur, duke i renditur, shkaqet e bëra prezent nga pala që ka bërë recurs. Shkaqet e rekursit në secilin dokument të vëzhguar, renditen në mënyrë të qartë dhe koncize, duke evidentuar edhe thelbin e argumenteve ligjore mbi të cilat pala ka mbështetur pretendimet e saj, duke qartësuar në këtë mënyrë edhe çështjet e zbatimit të ligjit procedural dhe material për të cilat pala i është drejtuar Gjykatës së Lartë. Në disa raste të cilat konsistojnë në mënyrën e interpretimit të ligjit material ose procedural, shkaqet e rekursit paraqiten duke risjellë edhe dispozitat ligjore të referuara nga pala¹⁰ si dhe analizën e palës në lidhje me ligjshmërinë e marrjes së provave apo vlerësimin e tyre në drejtim të cilësimit juridik të faktit penal apo aplikimit të dënimeve alternative¹¹.

- *Në lidhje me identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes:*

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezultojnë nga objekti dhe rrethanat e çështjes të përshkruara në pjesën hyrëse të relacionit si dhe shkaqet e rekursit, pavarësisht se nuk rezultojnë të jetë përcaktuar në mënyrë deklarative nga ndihmësmagjistratja në rekursin e analizuara. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe konciz i fakteve të çështjes (në varësi të kompleksitetit të çështjes në disa relacione është ndalur më gjatë e në disa më shkurt), ecurisë procedurale të gjykimit dhe veçanërisht të shkaqeve të rekursit, sjell si pasojë identifikimin e saktë të çështjes dhe përcakton natyrën specifike të çështjes sipas objektit të saj (*çështje penale themeli, çështje civile themeli, mosmarrëveshje pune*) si dhe lëndën e shqyrtimit nga Kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë në drejtim të aplikimit të ligjit procedural dhe/ose material penal dhe/ose civil.

- *Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm dhe konfliktit të normave:*

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes dhe evidentimi i qartë i natyrës së shkaqeve të rekursit, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës/Kolegjit për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar dokumenteve ligjore burim vlerësimi, rezultojnë se ndihmësmagjistratja në çdo rast ka identifikuar dhe referuar ligjin e

¹⁰ Relacion për çështjen civile me nr. 230000-01017-00-2013

¹¹ Relacion për çështjen penale me nr. 56430-01087-00-2012

zbatueshëm, në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, por edhe në 3 vendimet e përzgjedhura nga ajo për vlerësim.

Konkretisht, në 12 dokumentet ligjore burim vlerësimi, në pjesën e pasqyrit të mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton të jenë referuar dispozita të ligjit procedural civil/penal si më poshtë:

- neni 432 i KPr.Penale dhe 472 i KPr.Civile lidhur me konkluzionin se rekursi përmban ose nuk përmban shkaqe ligjore¹²;
- neni 140 i K.Pr.P lidhur me njoftimin e të pandehurit të lirë¹³;
- neni 406¹⁴ i KPr.Penale në lidhje me vendimin e marrë në një gjykim të shkurtuar;

Sa i përket identifikimit të ligjit material, në dokumentet ligjore burim vlerësimi të cilat lidhen me çështje të zbatimit të ligjit material civil, në pjesën e pasqyrit të mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton të jenë identifikuar dispozita të ligjit material të zbatueshëm, si më poshtë:

- nenet 371, 379¹⁵ të Kodit Civil lidhur me cënimin e rezervës ligjore nga trashëgimlënësi për personat e paaftë për punë dhe përkufizimin ligjor të tyre, neni 397¹⁶ të KC lidhur me mënyrën e redaktimit të testamentit, 326, 327, 360, 361, 362, 379 në lidhje me trashëgiminë¹⁷;
- nenet 46, 47 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”¹⁸ në lidhje me aktet dhe mënyrën e nënshkrimit të tyre;
- Vendimi nr. 90, datë 15.11.2010 i Bordit të Komisionerëve, ligji nr. 9997, datë 22.09.2008 dhe vendim nr. 77, datë 15.10.2010 të ERE-s “Mbi mosmiratimin e ndryshimeve në “Kodin e Matjes” në lidhje me mbifaturimet e paligjshme të kryera nga Cez shpërndarje nën emërtimin “Dëm ekonomik” apo “Energji e pamatur”¹⁹;
- nenet 140, 144, 155 të Kodit të Punës²⁰ në lidhje me marrëdhënie e unës me kohë të pacaktuar, me respektimin ose jo të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe zgjidhjes së kontratës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme si dhe neni 153²¹ i Kodit të Punës në lidhje me shkaqet e justifikuar të zgjidhjes së kontratës së punës;
- neni 143/2 i ligjit 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” në lidhje me kriteret e përcaktuara për regjistrimin e markës dhe emrit tregtar²²;
- nenet 76, 78 dhe 85 të Kodit të Familjes në lidhje me pasurinë e përbashkët bashkëshortore dhe 81 dhe 101 të Kodit të familjes në lidhje me detyrimet në bashkësi dhe kompensimet²³;

¹² Të gjitha relacionet (neni 432 i KPr.P në relacionet për çështjet penale dhe 472 i KPr.C në relacionet për çështjet civile)

¹³ Relacion për çështjen penale me nr. 53201-00841-00-2012

¹⁴ Relacion për çështjen penale nr. 56250-00893-00-2013

¹⁵ Relacion për çështjen civile nr. 11243-03063-00-2013 dhe relacion për çështjen civile nr.11117-02810-00-2013.

¹⁶ Relacion për çështjen civile nr. 11243-03063-00-2013

¹⁷ Relacion për çështjen civile nr. 11117-02810-00-2013

¹⁸ Relacion për çështjen civile nr. 11243-03063-00-2013

¹⁹ Relacion për çështjen civile nr. 11243-00225-00-2013

²⁰ Relacion për çështjen civile nr. 11241-01619-00-2013

²¹ Relacion për çështjen civile nr. 11241-01619-00-2013 dhe relacion për çështjen civile nr. 31003-03561-00-2013

²² Relacion për çështjen civile nr. 11243-02530-00-2012

²³ Relacion për çështjen civile nr. 23000-01017-00-2013

Sa i përket identifikimit të ligjit material, në dokumentet ligjore burim vlerësimi të cilat lidhen me çështje të zbatimit të ligjit material penal, në pjesën e pasqyrimin të mendimit të ndihmësit ligjor, rezultojnë të jenë identifikuar dispozita të ligjit material të zbatueshëm, si më poshtë:

- neni 59 i KP në lidhje me kushtet dhe kriteret e aplikimit të tij²⁴;
- nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal në lidhje me plagosjen e lehtë me dashje të kryer në bashkëpunim²⁵;
- neni 3 i ligjit nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie” i cili amnistion veprën penale “Largim nga vendi i aksidentit” parashikuar nga neni 273 i K.Penal²⁶.

Në disa raste ndihmësmagjistratja apo gjyqtarja (në varësi të funksionit që ushtronte), në funksion të analizës ligjore lidhur:

- me zbulimin e vërtetë të shakut të padisë i është referuar Vendimit Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012²⁷ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- me zbatimin e rezervës ligjore i është referuar vendimit nr. 1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁸;
- me mosparaqitjen si padi më vete të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nëse ky kërkim nuk shoqëron gjykimin e një çështjeje në themel apo/dhe shoqërohet me zgjidhjen e pasojave i është referuar Vendimit Unifikues nr. 5/2012²⁹.

Sa i përket evidentimit të konfliktit të normave, në një nga vendimet analizuara rezultojnë të jetë evidentuar dhe vendosur përballë njëra tjetrës si pjesë e arsytimit të mendimit të gjyqtarës, parashikimet e neneve 1050 dhe 653 të Kodit Civil, pra ndërmjet kontratës së huasë dhe pagimit të detyruar. Pavarësisht se nga paditësi është përcaktuar si bazë ligjore neni 1050, gjyqtarja zbulon shakun e padisë duke analizuar atë në tërësinë e saj.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për këtë tregues, vlerësohet edhe *aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator*. Në lidhje me aftësitë verbale të relatimit sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, pavarësisht se nuk rezultojnë të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, në vlerësimet e Kolegjit Penal dhe Civil për aftësitë profesionale të ndihmësit ligjor jepet vlerësimi maksimal.

Dokumentet ligjore që analizohen e përbëjnë burim vlerësimi për ndihmësmagjistratin në Gjykatën e Lartë, për efekt të kriterit të aftësisë profesionale sipas Metodologjisë së miratuar përfshijnë analiza, opinione, materiale studimore, etj.

Në 2 vendimet gjyqësore civile burim vlerësimi³⁰, sa i përket treguesit “*Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*”, rezultojnë se:

²⁴ Relacion për çështjen penale nr. 56250-00893-00-2013

²⁵ Relacion për çështjen penale nr. 56250-00893-00-2013

²⁶ Relacion për çështjen penale nr. 56430-01087-00-2012

²⁷ Vendim nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²⁸ Relacion për çështjen civile nr. 11117-02810-00-2013

²⁹ Relacion për çështjen civile nr. 11243-03063-00-2013

³⁰ Vendimi nr. 254, datë 17.03.2014 dhe vendim nr.1206, datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Faktet e çështjes evidentohen në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit” apo “Procedura gjyqësore dhe rrethanat e faktit”, duke u renditur në mënyrë kronologjike dhe logjike, ashtu sikurse ato kanë rezultuar të provuara për gjykatën nga shqyrtimi në tërësi i provave të administruara në gjykim. Faktet e çështjes fillojnë përgjithësisht me evidentimin e atyre me natyrë procedurale, duke u ndaluar në elementë të tillë si kërkesa e paditësit për të hequr dorë nga kërkitimi mbi kamatat³¹ apo krijimi i kushteve për pajtim³². Faktet thelbësore të çështjes referojnë në analizën dhe përmbajtjen e provave të administruara, prova të cilat janë të integruara dhe të analizuara në mënyrë të plotë. Elementë të këtyre të fundit, gjenden të pasqyruar dhe në pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të pasqyruara në mënyrë të ndarë e të dallueshme për secilën prej tyre si dhe janë pjesë e arsyetimit të gjyqtares lidhur me këto pretendime. Spikat aftësia e gjyqtares për paraqitjen koncize të rrethanave të faktit dhe rimarrja në analizë e tyre si pjesë integrale e pjesës arsyetuese të vendimit, duke paraqitur një analizë të detajuar dhe të plotë të provave mbi të cilat mbështeten rrethanat e faktit, sikurse ato kanë rezultuar të provuara në gjykim, duke dhënë në panoramë të qartë dhe ezauruese të provave dhe fakteve që burojnë prej tyre.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në dy vendimet gjyqësore të analizuara, gjyqtarja përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes, paraqitjes së pretendimeve dhe qëndrimit të palëve dhe referimit në dispozitat ligjore të zbatueshme. Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet në mënyrë të qartë dhe të shprehur, bazuar në natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, madje duke zbuluar vetë shkakun e padisë, pa u kufizuar nga dispozitat ligjore të referuara nga paditësi³³ (*kthim shume apo begatim pa shkak*).

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se pas pasqyrimin dhe analizës së fakteve të çështjeve dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja referon dhe/ose citon dispozitat përkatëse të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht, në 2 vendimet e analizuara, identifikohen, referohen dhe/ose citohen dispozitat ligjore si më poshtë :

- neni 8/1i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtën e çdo individit që t’i respektohet jeta private dhe familjare, banesa dhe korrespondenca, duke futur këtu edhe të drejtën e fëmijës për të mbajtur marrëdhëniet me të dy prindërit kur është në interesin më të lartë të tij³⁴.
- lidhur me zbulimin e vërtetë të shkakut të padisë i është referuar Vendimit Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 dhe Vendimi nr. 5, datë 30.10.2012³⁵ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me përcaktimin e shkakut ligjor nga vetë gjykata dhe konstatimin kryesisht të veprimin juridik të pavlefshëm;
- nenin 83 dhe 92 të K Civil në lidhje me formën dhe pavlefshmërinë e veprimeve juridike dhe 653 të Kodit Civil në lidhje me pagimin e padetyruar³⁶;

³¹ Vendimi nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

³² Vendim nr. 1206, datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³³ Vendimi nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁴ Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

³⁵ Vendim nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁶ Vendim nr.254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

- neni 510 i KPr.Civile në lidhje me përcaktimin e titujve ekzekutivë; nenet 511 dhe 310 të KPr.Civile ndryshuar e shtuar me ligjin 122/2013 në lidhje me mënyrën dhe kushtet e vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë³⁷;
- 185 i KPr.C në lidhje me heqjen dorë nga kërkimi i kamatave³⁸;
- nenet 25 dhe 158/b të KPr.Civile në lidhje me përpjekjen për të pajtuar palët në seancë përgatitore³⁹.
- nenet 123 të KF në lidhje me mbarimin e martesës, nenet 125, 129 dhe 132 të KF lidhur me mënyrat e mbarimit të martesës (me pëlqimin e përbashkët, me ndërprerjen e jetës së përbashkët dhe me kërkesën e njërit bashkëshort)⁴⁰;
- neni 133 të KF në lidhje me kushtet mbi të cilat gjykata vendos për fajësinë⁴¹;
- nenet 146-153 të KF në lidhje me rrimarrjen e mbiemrit të mëparshëm pas zgjidhjes së martesës për bashkëshortin që e ka ndryshuar atë, në lidhje me pasojat me karakter pasuror që vijnë si pasojë e zgjidhjes së martesës, neni 143 i KF në lidhje me urdhërimin e gjendjes civile për ndryshimin e mbiemrit⁴²;
- nenet 3/1, 5, 155, 157, 158, 159, 215, 216 dhe 220 të KF në lidhje me përgjegjësinë prindërore, mënyrën e ushtrimit të saj, mundësinë e ndryshimit dhe përgjegjësitë prindërore të prindit të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim⁴³;
- nenet 161, 192, 196, 197, 201, 202 në lidhje me caktimin e detyrimit ushqimor në vendimin e zgjidhjes së martesës, personat që e përfitojnë atë, detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve edhe kur i hiqet përgjegjësia prindërore apo kur fëmijët vazhdojnë studimet dhe balanca e detyrimit për ushqim mes nevojës së atij që e kërkon dhe atij që detyrohet⁴⁴.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja {...} ka shfaqur aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar më provat e administruara, pasqyrimin e ecurisë procedurale të çështjes në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve arsyet thelbësore të arsyetimit të këtyre gjykatave, vetëm lidhur me atë pjesë të vendimit që lidhet me shkaqet e rekursit, veçanërisht në rastet kur qëndrimi i gjykatave është i ndryshëm. Sa i përket identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në rastin konkret, në aktet e analizuara referohet norma procedurale penale/civile në lidhje me shkaqet e rekursit dhe mungesën e elementeve të pavlefshmërisë absolute të vendimeve të ankimuar, ndërsa sa i përket ligjit material të zbatueshëm, ai identifikohet dhe referohet në shumicën e akteve të analizuara, përveç ndonjë rasti specifik kur shkaqet e rekursit konsistojnë në drejtim të fakteve të çështjes dhe jo zbatimit të ligjit. Në vlerësimin e këtij treguesi janë marrë në konsideratë dhe vendimet gjyqësore burim vlerësimi,

³⁷ Vendim nr.254/U, datë 17.03.2014 dhe vendim nr. 1574/U datë 23.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁸ Vendim nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁹ Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴⁰ Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴¹ Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴² Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴³ Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴⁴ Vendim nr.1206 datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

nga analiza e të cilëve rezulton shkallë shumë e lartë kujdesi e gjyqtarës për të përshkruar në mënyrë të qartë, koncize dhe të plotë faktet e çështjes, për të identifikuar dhe përcaktuar qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes dhe për të identifikuar ligjin e zbatueshëm, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe ligjin material në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ÇËSHTJET LIGJORE MATERIALE DHE PROCEDURALE, PËR TË CILAT I KËRKOHET PËRGATITJA E ANALIZËS APO OPINIONIT LIGJOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, lidhur detyrat e ndihmësit ligjor, në nenin 21 parashikohet se: “Ndihmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë.” Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në nenin 25, pika 1 të tij parashikon se: “Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”

Sa më sipër, interpretimi i ligjit procedural dhe/ose material të zbatueshëm në funksion të mbështetje të opinionit të ndihmësmagjistratit për zgjidhjen e çështjes, paraqet rëndësi me qëllim përmbushjen në mënyrë cilësore të funksionit të tij ndihmës për Kolegjin, në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete.

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi, normat procedurale dhe materiale relevante për zgjidhjen e çështjes, identifikohen dhe, sipas rastit aplikohen drejtpërdrejt, ose interpretohen duke identifikuar qëllimin e tyre, dhe më pas aplikohen mbi faktin konkret, në shërbim të

konkluzionit të arritur nga ndihmësmagjistratja në mbështetje të opinionit të saj mbi zgjidhjen e çështjes. Interpretimi i normave ligjore të zbatueshme, evidentohet kryesisht në lidhje me normat e ligjit penal/civil material dhe ligjit procedural kur ky i fundit është thelbësor për zgjidhjen e çështjes. Në raste të tjera, dispozitat procedurale penale/civile referohen ose citohen dhe aplikohen mbi opinionin e ndihmësit ligjor lidhur me mënyrën e aplikimit të tyre, pa u interpretuar në mënyrë të pavarur pasi konsistojnë në elementë procedurale të tillë si prezenca ose mungesa e shkaqeve të rekursit etj., elementë që nuk kanë lidhje me shkaqet e rekursit por lidhen me aspektet procedurale të vlerësuara paraprkasht nga ndihmësmagjistratja në çdo rast të trajtuar.

Sa i përket interpretimit të ligjit procedural penal, rezulton si më poshtë:

- (i) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 53201-00841-00-2012 ndaj të pandehurit GB, duke iu referuar shkaqeve të ngritura në rekurs, ndihmësmagjistratja ka referuar dhe interpretuar dispozitat procedurale penale që lidhen me njoftimin (neni 140 i K.Pr.P), duke e analizuara atë në kontekstin e të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke zbatuar kështu parimi i kontradiktoritetit. Ndhmësmagjistrates ka dhënë mendimin se në këtë rast janë respektuar rregullat procedurale të parashikuar në këtë nen për njoftimin e të pandehurit, duke u bërë fillimisht njoftimin në banesë, njoftimi nëpërmjet policisë gjyqësore, kërkimi i të pandehurit dhe në fund është marrë vendimi për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Në këtë relacion ndihmësmagjistratja ka bërë interpretimin në lidhje me cilësimin juridik të veprës penal, duke dhënë mendimin se gjykata ka bërë një cilësim të gabuar të veprës penale.

Sa i përket interpretimit të ligjit material penal, rezulton si më poshtë:

- (ii) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 56250-00893-00-2013 që i përket të pandehurit RD, në pjesën që referon mendimin e saj, ndihmësmagjistratja referon nenin 59 të K. Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në lidhje me kushtet e zbatimit të tij, në kushtet kur i pandehuri ka rezultuar se kishte një dënim penal të mëparshëm, konkretisht ka rezultuar se ishte i dënuar për kryerjen e veprës penale të « Plagosjes së lehtë me dashje» e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenit 89 dhe neni 25 i K Penal. Në këtë rast, ndihmësmagjistratja ka ka ngritur për diskutim përpara Kolegjit rrezikshmërinë e autorit, në kushtet kur ka qenë i dënuar, si dhe kushtet e kriteret e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal.
- (iii) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 56430-01087-00-2012 që i përket të pandehurit KM, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja ka referuar dhe interpretuar nenin 3 të ligjit nr. 107/2012 «Për dhënie amnistie», sipas të cilit dënimi i dhënë për të gjykuarin KM për kryerjen e veprës penale të «Largimit nga vendi i aksidentit » të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal është amnistuar, në kushtet kur vendimi penal ka marrë formë të prerë përpara datës 28.11.2012, datë kur ka hyrë në fuqi ky ligj. Ndërsa në lidhje me veprën penale të « Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor», ka dhënë mendimin se nga gjykatat është respektuar drejt ligji material penal.

Sa i përket interpretimit të ligjit material civil, rezulton si më poshtë:

- (i) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 31003-03561-00-2013 që i përket paditësit EH dhe të paditurit Ujësajllës Fshat sha Korçë, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja ka referuar nenin 153 të K. Punës lidhur me zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për shkaqe të justifikuar nga pala punësmarrëse. Sipas saj kontrata është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme nga pala paditëse për shkak të gjendjes shëndetësore të tij që kushtëzon vazhdimin e marrëdhënieve të punës.
- (ii) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 23000-01017-00-2013 që i përket paditësit EZh dhe të paditurit DhZh, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja interpreton nenin 101 të K. Familjes lidhur me kompensimin e shumave të marra nga pasuria e bashkësisë, detyrimin e të paditurit t'i kompesojë bashkësinë me shumat e marra, të cilat janë përdorur nga ana e tij për qëllime të ndryshme nga ai i përmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga neni 81 i Kodit Penal. Gjithashtu, ndihmësmagjistratja ka dhënë mendimin se nga ana e gjykatave të faktit nuk janë zbatuar drejtë dispozitat në lidhje me nenin 76, 78 dhe 85 të Kodit të Familjes, duke arsyetuar se shumat janë tërhequr nga njëri prej bashkëshortëve jo për nevojat e bashkësisë.
- (iii) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11243-02530-00-2012 me paditësit shoqëria “Galina” shpk dhe të paditurit shoqëria “Roal” shpk, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja interpreton nenin 143/2 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” lidhur me të drejtën e emrit tregtar, regjistrimin e markës, duke arsyetuar se marka është e drejtë pasurore, në kundërshtim të pronësisë industriale të një shoqërie tregtare, Ndhimësmagjistratja e gjen të pabazuar pretendimin e paditësit në lidhje me cënimin e emrit tregtar sepse referuar objektit të veprimtarisë, fusha e veprimtarisë së subjektit tjetër tregtar është shumë e gjërë. Gjithashtu ka arsyetuar se edhe sikur të provohet se jemi përpara një emri të ngjashëm duhet që prodhimet e ngjashme apo të njëjta që ai tregton të jenë të regjistruar që mund të jemi përpara cënimit të emrit tregtar.
- (iv) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11243-00225-00-2013 që i përket paditësit MB dhe të paditurit Cez Shpërndarje sha në mendimin e saj ndihmësmagjistratja interpreton shfuqizimin e neneve 46/1 dhe pjesërisht të nenit 46/2/c të ligjit 9072/2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” nga ligji nr. 9997 datë 22.09.2008, i cili i ka hequr të drejtën furnizuesve të marrin masa administrative (të vendosin gjoba) ndaj dëmit të shkaktuar nga marrja e paligjshme e energjisë elektrike dhe nga ana tjetër e drejta për të nxjerrë rregulla apo vlerësime ç’dëmtimi nuk i janë deleguar ndonjë institucioni tjetër shtetëror. Në këtë kontekst ndihmësmagjistratja merr në analizë edhe vendime të ERE-s (vendim nr. 90, datë 15.11.2010) e cila ka monitoruar procedurat e ndjekura nga Cez Shpërndarje dhe ka konstatuar që aplikimi i “Dëmit ekonomik” apo “Energji e pamatur” është kryer në mënyrë abuzive dhe arbitrare pasi këto veprime nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
- (v) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11241-01619-00-2013 që i përket paditësit ED dhe të paditurit “KESH SECURITY SHRSF” sha, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja interpreton nenet 140, 144, 153 dhe 155 të Kodit të Punës në lidhje me marrëdhënien e punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, procedura e

zgjdhjes së saj nga punëdhënësi, zgjidhja e kontratës për shkaqe të justifikuara apo të pajustificuara. Ndhmësmagjistratja arrin në konkluzionin që përderisa paditësi i ka përmbushur me përpikmëri të gjitha detyrimet e tij ligjore që burojnë nga kontrata individuale e punës dhe nuk ka kryer asnjë shkelje të rëndë apo të lehtë gjatë gjithë periudhës së punës, atëherë kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara dhe i padituri duhet të përgjigjet për pasojat.

- (vi) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11243-03063-00-2013 që i përket paditësit HM dhe të paditurit HM, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja citon nenet 371 dhe 379 të Kodit Civil që përcaktojnë personat që nuk mund të përjashtohen nga trashëgimia ligjore sikurse janë trashëgimtarët e paaftë për punë dhe kush quhen persona të paaftë për punë. Këto përkufizime duke i ndërthurur me provat dhe rrethanat e çështjes, ndihmësmagjistratja del në konkluzionin që nuk është cënuar rezerva ligjore, pasi në momentin e çeljes së trashëgimisë personi nuk ka gëzuar statusin e personit të paaftë për punë. Gjithashtu ndihmësmagjistratja citon nenet 397 të KC dhe nenet 46, 47 të ligjit “Për noterinë” që lidhet me mënyrën e hartimit të testamentit dhe mënyrën e nënshkrimit të akteve dhe nga interpretimi i bërë, duke i ndërthuar me provat shkresore del në konkluzionin që jemi para një akti absolutisht të pavlefshëm, pavlefshmëri e cila mund të konstatohet nga gjykata dhe nuk mund të ngrihet si padi më vetë konstatimi i pavlefshmërisë abso kryesisht. Në këtë rast, ajo ka shtruar për diskutim përpara kolegjit, nëse mund të ngrihet padia me objekt deklarin e pavlefshëm të testamentit si dhe fshirjen e regjistrimit nga ZRPP në referim të vendimit unifikues nr.5/2012, që përcakton se padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të ngrihet si një padi më vete sikurse ka vepruar pala paditëse, nëse ky kërkim nuk shoqëron gjykimin e një çështje në themel dhe ose nuk shoqërohet me zgjidhjen e pasojave. Gjithashtu, ndihmësmagjistratja ka parashtruar edhe pretendimin e palës paditëse se atij i është cënuar pjesa dhe mendimin e saj se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuar nga neni 472 të KPRC.
- (vii) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11117-02810-00-2013 që i përket paditësit AA, PD etj., dhe të paditurit VV dhe SV, në mendimin e saj ndihmësmagjistratja referon dhe bën një interpretim të përgjithshëm të neneve 326, 327, 360, 361, 362 dhe 379 në lidhje me trashëgimin ligjore, përfituesit, zëvendësimin dhe rezervën ligjore të cilat i shtron për diskutim përpara Kolegjit. Ajo interpreton se në zbatim të këtyre neneve, në llogaritjen e pjesëve që do u takonin fëmijëve të mitur nëse do të zbatohesh trashëgimia ligjore, gjykatat nuk duhet të kishin përfshirë bashkëshortët. Ka vijuar me arsyetimin se fëmijët e mitur janë trashëgimtarë të cilët trashëgojnë në vitë të drejtë, ndaj në zbatim të nenit 379 të Kodit Civil, pjesa që do të përfitonte prindi i përjashtuar nga trashëgimia duhet të ndahej mes fëmijëve të mitur, duke referuar në këtë rast dhe vendimin unifikuar nr.1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara në lidhje me rezervën ligjore. Në përfundim ajo konkludon se ka shkaqe nga ato që parashikohen nga neni 472 të KPRC.

Në dy dokumente ligjore të analizuara, në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, nuk ka interpretim të ligjit procedural ose material, në funksion të çështjeve të mundshme për diskutim apo në mbështetje të mendimit të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes, por kjo është e kushtëzuar nga natyra e shkaqeve të rekursit dhe çështjet e vlerësuara si të nevojshme për t'u analizuar. Konkretisht në një rast ndihmësmagjistratja shprehet se nuk ka shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPr.Penale dhe rekursi nuk duhet të pranohet⁴⁵. Në rastin e dytë⁴⁶, në pamje të parë, duket sikur ndihmës magjistratja nuk ka referuar apo interpretuar asnjë nen të ligjit material civil, por në të vërtetë ka bërë një arsyetim ligjor të të gjithë mosmarrëveshjes duke dhënë orientimin ku duhet të fokusohet zgjidhja e çështjes. Ndihmësmagjistratja sugjeron për diskutim në Kolegj natyrën juridike të marrëdhënies që ka ekzistuar mes palëve ndërgjyqës për të kuptuar nëse jemi përpara një marrëdhënie kontraktore apo të një marrëdhënie që rregullohet nga ligji për shoqëritë tregtare. Gjithashtu, evidenton dhe natyrën e marrëdhënies juridike të krijuar, duke dalë në konkluzionin se është përpara një marrëdhënie pune, apo një mosmarrëveshje në kuadrin e marrëdhënies juridike të trashëgimisë.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se, pavarësisht nëse janë identifikuar më mënyrë të shprehur ose jo, referohen parimet e procesit të rregullt ligjor, kryesisht në lidhje me të drejtën për një hetim të plotë e të gjithëanshëm⁴⁷, parimi i kontradiktoritetit⁴⁸, të interesit të ligjshëm.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, në 10 nga 12 dokumentet ligjore të analizuara, nuk rezulton në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, referimi në jurisprudencën relevante vendase ose ndërkombëtare. Në njërin rast⁴⁹, në mbështetje të analizës ligjore lidhur me paraqitjen apo jo më vete të padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, ndihmësmagjistratja i referohet Vendimit Unifikues nr. 5/2012. Në rastin tjetër⁵⁰, në mbështetje të analizës ligjore lidhur me zbatimin e rezervës ligjore (neni 379 i Kodit Civil), ndihmësmagjistratja i referohet vendimit nr. 1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara.

Në tërësi, në shumicën e dokumenteve ligjore të analizuara, përveç 2 prej tyre, rezulton të ketë interpretim të dispozitave ligjore procedurale ose materiale që zbatohen në zgjidhjen e çështjes, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes. Në rastet e tjera, duke u determinuar nga shkaqet e rekursit, argumentet e ndihmësmagjistrates për mospranimin e rekursit, përqendrohen në analizën e fakteve dhe rrethanave konkrete, pasi ato nuk konsistojnë në mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural ose material.

Lidhur me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi, dispozitat ligjore të identifikuar si të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, shoqërohen në çdo rast me interpretim paraprak, duke përcaktuar qëllimin e tyre,

⁴⁵ Relacion për çështjen penale nr. 52203-01532-00-2012

⁴⁶ Relacion për çështjen civile nr. 11118-02240-00-2013

⁴⁷ Relacion për çështjen penale nr. 53201-00841-00-2012

⁴⁸ Po aty

⁴⁹ Relacion për çështjen civile nr. 11243-03063-00-2013

⁵⁰ Relacion për çështjen civile nr. 11117-02810-00-2012

elementet përbërës si dhe kushtet dhe kriteret ligjore të aplikimit, para aplikimit mbi faktin konkret në shërbim të të cilit ato analizohen.

Konkretisht, *në lidhje me normat procedurale*, gjyqtarja ka interpretuar dispozita të ligjit procedural civil në lidhje me (i) institutin procedural të gjykimit të shkurtuar; (ii) dispozitat procedurale në lidhje me; (iii) dispozitat ligjore lidhur me

Sa i përket *dispozitave me karakter material*, të identifikuar si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjeve konkrete, gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit literal të dispozitës dhe zbërthimit të saj duke e ndërthurur me rrethanat e çështjes dhe provat shkresore që e bën shumë më të qartë analizën ligjore. Konkretisht:

- (i) interpreton nenin 83 dhe 92 të Kodit Civil në lidhje me formën e veprimit juridik për kalimin e e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe vlefshmërisë së tij vetëm nëse kryhet në formën e caktuara nga ligji⁵¹;
- (ii) interpreton dhe konfronton mes tyre nenet 1050 dhe 653 të KC për të zbuluar kryesisht shkakun e padisë, nëse jemi para një padie për kthim shume apo të pagimit të padetyruar. Pavarësisht nga objekti i padisë, Gjykata nëpërmjet interpretimit arrin në konkluzionin që jemi para marrëdhënies së një pagimimi të padetyruar⁵²;
- (iii) interpreton nenin 132⁵³ të Kodit të Familjes në lidhje me një nga format e mbarimit të martesës, atë me kërkesën e njërit bashkëshort për shkaqet e parashikuara në ligj, duke pasqyruar shkaqet e zgjidhjes e sidomos duke u ndalur tek detyra e Gjykatës për të vlerësuar këtë/këto shkak/shkaqe të pretenduar nga paditësja. Gjyqtarja vlerëson se Gjykata duhet të analizojë me kujdesin e duhur dinamikën e marrëdhënieve bashkëshortore, natyrën e shkakut që çon në zgjidhjen e martesës, kohëzgjatjen e shkakut, qëndrimet subjektive etj;
- (iv) interpreton nenin 133⁵⁴ të KF në lidhje me fajësinë dhe konkludon se nuk është detyrimi ligjor i Gjykatës të përcaktojë fajësinë nëse nuk kërkohet shprehimisht nga njëri ose nga të dy bashkëshortët; i
- (v) interpreton nenin 146 të Kodit të Familjes në lidhje me rimarrjen e mbiemrit të vet nga bashkëshorti i cili e ka ndryshuar me martesë, përveç kur ka kërkesë nga bashkëshorti apo është në interes të tij apo të fëmijës mosndryshimi i mbiemrit dhe 143 të KF duke urdhëruar Zyrën e Gjendjes Civile të bëjë ndryshimin e mbiemrit⁵⁵;
- (vi) interpreton nenin 216 të KF në lidhje kufijtë e përgjegjësisë prindërore, nenin 220 të KF në lidhje me ushtrimin e kësaj përgjegjësie, nenin 3/1 të KF në lidhje me detyrimin dhe të drejtën e prindërit për kujdesin ndaj fëmijës dhe nenin 5 të KF në lidhje me ambientin më të mirë të mundshëm që duhet të rritet një fëmijë⁵⁶;
- (vii) interpreton në mënyrë të përgjithshme pasoja me karakter pasuror të parashikuar në nenet 147-153⁵⁷ të KF dhe konkludon që këto pasoja nuk mund të merren në konsideratë kryesisht nga Gjykata pasi mund të pretendohen vetëm me kërkesë të palëve;

⁵¹ Vendimi nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵² Po aty

⁵³ Vendimi nr. 1206, datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵⁴ Po aty

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Po aty

⁵⁷ Po aty

(viii) interpreton nenet 155, 157 dhe 159 të KF në lidhje me palën që garanton alternativën më të mirë për mirëqënien e fëmijëve dhe interesin më të lartë të tyre⁵⁸.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, gjyqtarja zbaton (i) parimin e interesit më të lartë të fëmijës si dhe garantimin e respektimit e të drejtave dhe lirive të njeriut, posaçërisht të të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8/1 i KEDNJ), që jo vetëm referohen drejtpërdrejt në vendimin me objekt “zgjidhje e martesës ligjore, lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve ...”⁵⁹, por rezulton edhe nga arsyetimi i të gjithë vendimit, (ii) parimin e interesit të ligjshëm në ngritjen e padisë në interes të zbatimit të tij referon edhe Vendimin Unifikues 01/2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin me objekt “Kthim shume”⁶⁰.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi, për të mbështetur argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural dhe material, gjyqtarja referon:

- (i) Vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 lidhur me veprimin juridik të pavlefshëm, i cili, sipas Kolegjeve merret parasysh nga Gjykata edhe kryesisht, pa kërkesën e palëve edhe madje pa vullnetin e tyre dhe në rregullimin e pasojave Gjykata shprehet vetëm për ato pasoja që janë objekt kërkimi të padisë⁶¹;
- (ii) Vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 lidhur me shkakun e padisë, i cili, sipas Kolegjeve zbulohet nga Gjykata duke analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj⁶²;
- (iii) Vendimin unifikues nr. 1, datë 09.01.2008 lidhur me konceptin e legjitimitetit, i cili, sipas Kolegjeve zbulohet nga Gjykata duke analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj⁶³;
- (iv) Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 1009, datë 25.10.2002 lidhur me konceptin e pagimit të padetyruar dhe kushtet kur jemi para tij⁶⁴.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se znj. {...}, si në cilësinë e ndihmësit ligjor ashtu edhe në cilësinë e gjyqtarës, ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete, në mbështetje të opinionit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjeve konkrete të ngritura në rekurs apo në funksion të zgjidhjes së

⁵⁸ Po aty

⁵⁹ Vendimi nr. 1206, datë 23.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁶⁰ Vendimi nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶¹ Vendimi nr. 254, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶² Po aty

⁶³ Po aty

⁶⁴ Po aty

çështjes në vendimet gjyqësore burim vlerësimi. Evidentohet kujdesi i saj për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Parimet e përdorura në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e së drejtës, integrohen në arsyetim në funksion të konkluzioneve/ opinionit mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.*

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “ndër tri vendimet gjyqësore të vëzhguara, dy prej tyre nuk kanë rezultuar të cenuara nga Gjykata e Apelit apo nga Gjykata e Lartë. Subjekti i rivlerësimit {...}, në cilësinë e gjyqtarës, ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Në cilësinë e ndihmësligjorit në Gjykatën e Lartë evidentohen cilësi të mira në arsyetimin ligjor në 6 relacionet e vëzhguara... Në lidhje me detyrën e ndihmësligjorit të kryer nga znj. {...} në Gjykatën e Lartë, në aktvlerësimet e kësaj të fundit, kryer për periudhat 2014 - 2015 dhe prill 2015 - prill 2016, evidentohet fakti se subjekti i rivlerësimit jep mendime të argumentuara ligjërisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me aspektin e njohurive ligjore, konkludohet se : “Znj. {...} është vlerësuar nga Gjykata e Lartë se është e aftë të shkruajë thjesht dhe qartë projektvendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë.”

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E DOKUMENTIT LIGJOR

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes në përmbushje të detyrës së ndihmësit ligjor në funksion të relatimit të qartë, konciz, tërësor dhe lehtësisht të kuptueshëm të çështjes para Kolegjit përkatës së Gjykatës së Lartë.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;

- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me këtë tregues vlerësohet qartësia, konciziteti, elokuenca dhe lehtësia në kuptimin dhe leximin e dokumenteve ligjore, aftësia për të prezantuar verbalisht çështjen para Kolegjit kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurën e zbatueshme, arsyetimin e gjykatave me të ulëta dhe çështjet e tjera ligjore.

Në rastin konkret, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se gjuha e përdorur nga ndihmësmagjistratja është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës dhe morfologjisë në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte, në funksion të kuptueshmërisë dhe qartësisë së përmbajtjes së tyre. Nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i termave teknikë.

Ndihmësmagjistratja përdor fjali me gjatësi mesatare, të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Paragrafët dhe nënndarjet e përmbajtjes së dokumentit ligjor janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk krijojnë shkëputje të logjikës së ndërtimit të tyre, brenda së njëjtës nënndarje të dokumentit ligjor apo në tërësi.

Sa i përket paraqitjes së mendimit të ndihmësit ligjor, ndihmësmagjistratja ka treguar një shkallë e lartë kujdesi në paraqitjen e plotë dhe të qartë të mendimit të ndihmësit ligjor dhe arsyetimit përkatës në mbështetje të tij, pavarësisht nëse pjesa arsyetuese e dokumentit është e shkurtër ose e zgjeruar, në varësi të natyrës së çështjes dhe shkaqeve të rekursit. Kjo pasi në disa raste mendimi i ndihmësit ligjor dhe mënyra e organizimit dhe paraqitjes së tij kushtëzohet edhe nga natyra e çështjesh, pasi në ato raste kur mendimi i ndihmësit ligjor konsiston në mungesën e shkaqeve të rekursit sipas parashikimeve të ligjit procedural, shoqërohet me paraqitjen në mënyrë të shkurtuar të arsyes mbi të cilën mbështetet ky vlerësim. Në rastet e tjera, ndihmësmagjistratja ka paraqitur mendimin e saj në mënyrë logjike, duke integruar pjesë të përmbajtës së ligjit të zbatueshëm, interpretimit të tij, dhënien e arsyeve mbi kuptimin edhe interpretimin e ligjit dhe aplikimin e tij mbi faktet e çështjes, për të konkluduar me mendimin e saj mbi zgjidhjen përfundimtare, e cila vjen në formën e sugjerimit apo opinionit drejtuar Kolegjit.

Sa i përket aftësive të ndihmësmagjistrates për të prezantuar verbalisht çështjet para Kolegjit, nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, por referuar vlerësimeve të Kolegjit për aftësitë profesionale të ndihmësmagjistrates, të gjithë komponentët e këtij kriteri janë vlerësuar maksimalisht.

Lidhur me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi, gjyqtarja është e qartë, e kuptueshme dhe konkrete dhe e drejtpërdrejtë në mënyrën e shprehjes së mendimit juridik. Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës që përmenden në arsyetim gjithnjë i referohen në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet në asnjë rast përdorim i fjalëve që çënojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Ashtu si në dokumentet ligjore burim vlerësimi, edhe në vendimet gjyqësore të analizuar, gjyqtarja përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore, të sintaksës dhe morfologjisë, duke i bërë vendimet të qarta, të kuptueshme dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor dhe në përmbajtje.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe në rrjedhë logjike, duke dëshmuar në mënyrën e shprehjes dhe organizimit të arsyetimit, qartësinë, logjikën dhe rrjedhshmërinë e mendimit. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të organizuara sipas në vijueshmërie logjike.

KONKLUZIONI

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin qartë, konciz dhe të saktë të fakteve apo rrethanave të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit, shkaqeve të rekursit dhe në arsyetimin ligjor të opinionit të saj drejtuar Kolegjit. Në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të koncizitetit dhe kuptueshmërisë të mendimit të ndihmësit ligjor lidhur me zgjidhjen e çështjes apo evidentimin e çështjeve për diskutim para Kolegjit. Edhe në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin, koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E DOKUMENTIT LIGJOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Dokumentet ligjore të hartuar nga ndihmësmagjistratja ndjekin strukturë të njëjtë dhe të standardizuar duke përmbajtur elementët thelbësore të relacionit sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në nenin 25, pika 1 të së cilës parashikohet se: *“Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”*

Përmbajtja e dokumenteve ligjore është e ndarë në paragrafë, të cilët lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri dhe duke iu përmbajtur nënndarjes përkatëse. Përdorimi i titujve mundëson lexim të organizuar të dokumentit ligjor dhe respektim të strukturës standarde të miratuar, mbi bazën e së cilës hartohet dokumenti ligjor (relacioni).

Relacionet e përgatitura nga ndihmësmagjistratja, të organizuara sipas të njëjtës strukturë, përmbajnë në pjesën hyrëse identifikimin e çështjes, të dhënat e palëve, objektin dhe bazën ligjore (*referencën në ligjin material në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit apo objektin e padisë*). Përmbajtja e relacioneve është e organizuar në disa pjesë, të identifikuar me titujt përkatës sipas përmbajtjes, si më poshtë: (i) *rrethanat e çështjes*. Në këtë pjesë përshkruhen në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit lidhur me çështjen objekt gjykimi, duke integruar sipas rastit edhe pjesë të provave mbi të cilat mbështeten elementë të caktuar të faktit; (ii) *procedura gjyqësore*, shoqëruar me paraqitjen e vendimmarrjes së gjykatave të faktit dhe paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të pjesëve thelbësore të arsyetimit të vendimeve, duke u përqendruar në ri sjelljen e asaj pjesë të arsyetimit që lidhet me shkaqet e rekursit; (iii) *rekursi*. Në këtë pjesë pasqyrohet ushtrimi i së drejtës së rekursit nga palët duke renditur në mënyrë të përmbledhur shkaqet thelbësore të rekursit, shoqëruar në disa raste me pjesë të arsyetimit të shkaqeve, sipas pretendimeve të palës që ka investuar gjykatën; (iv) *mendimi i ndihmësit ligjor*. Në këtë pjesë të relacionit parashtrohet vlerësimi për njoftimin e rekursit, paraqitjen e tij në formën e kërkuar nga ligji dhe mungesa e shkaqeve të pavlefshmërisë së vendimeve në referim të nenit 128 të K.Pr.P. Më pas parashtrohet shkurtimisht konkluzioni i ndihmësit ligjor lidhur me prezencën ose jo të shkaqeve ligjore të rekursit dhe më tej jepen arsytet që mbështesin mendimin e ndihmësit, duke referuar në disa raste dispozitat e ligjit procedural/material të zbatueshëm, si dhe argumenteve ligjore që mbështesin mendimin e dhënë apo çështjet e ngritura për diskutim kur është rasti.

Në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi, konstatohet se gjyqtarja ndjek kryesisht të njëjtën strukturë, e cila është qëndrueshme, e organizuar dhe e standardizuar. Vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin, sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.Civile.

Në pjesën hyrëse të vendimit gjen pasqyrim trupi gjykues, sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët ndërgjyqëse (me të dhënat për gjeneralitetet, adresën dhe përfaqësimin në gjykatë), objekti i kërkesës padisë, baza ligjore dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë sipas përmbajtjes, në pjesë në të cilat, në varësi të kompleksitetit të çështjes, pasqyrohen në mënyrë të detajuar: (i) *rrethanat e faktit*. Rrethanat e faktit civil objekt shqyrtimi përshkruhen dhe analizohen në mënyrë të detajuar dhe logjike, duke referuar ose integruar herë pas here pjesë nga provat e administruara, mbi të cilat është konkluduar për elementë të caktuar të faktit civil; (ii) *vlerësimi i gjykatës*. Në këtë pjesë shtjellohet procesi analitik i vlerësimit të provave, interpretimi abstrakt i ligjit dhe argumentimi i zbatimit të tij mbi faktet e provuara. Gjykatata vlerëson kryesisht bazën ligjore edhe pse pala mund t'i jetë drejtuar gjykatës me një tjetër shkak i cili nuk ka rezultuar nga sqarimet e palëve. Analiza e detajuar e çështjeve të ngritura për diskutim si dhe e çdo pretendimi të palëve, e cila përfundon me një konkluzion përmbyllës, tërësia e të cilëve përbën konkluzionin përfundimtar mbi zgjidhjen e çështjes. Në një çështje tjetër më komplekse nëndarjet bëhen me tituj përkatës dhe për ndonjë titull ka nëntituj të tjerë: 1. *Procedura gjyqësore dhe rrethanat e faktit* përshkruan rrethanat e faktit civil objekt shqyrtimi dhe analizohen në mënyrë të detajuar dhe logjike, duke referuar ose integruar herë pas here pjesë nga provat e administruara. 2. *Analiza juridike e gjykatës në lidhje me kërkimin për zgjidhjen e martesës* ku citohen dhe interpretohet ligji material në lidhje me kur, si dhe pse zgjidhet martesë. 3. *Analiza juridike e Gjykatës në lidhje me pasojat ligjore të zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët* ku citon dhe interpreton nenet e ligjit material në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët (me karakter vetiak dhe pasuror) dhe fëmijët e tyre. 4. *Analiza juridike e gjykatës në lidhje me pasojat ligjore të zgjidhjes së martesës për fëmijët* e cila nga ana e saj përbëhet nga disa nëndarje si : i. *Përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore* ku evidenton të drejtën e fëmijëve dhe prindërve për të pasur një marrëdhënie të shëndetshme edhe pas përfundimit të martesës. ii. *Përcaktimi i modaliteteve të ushtrimit të së drejtës së takimit* ku thekson të drejtën e të dy prindërve për të pasur kontakte me fëmijët edhe pse ata i janë lënë për rritje dhe edukim vetëm njërit prej tyre. iii. *Përcaktimi i detyrimit për ushqim për fëmijët* duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës, kërkesat specifike të tij, situatën ekonomike të palëve dhe aftësinë e tyre për punë si dhe nevojat personale të vetë palëve.

Në pjesën e diapozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, i cili është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese–arsyetuese. Dispozitivi përmban disponimin mbi pranimin e padisë, kthimin e shumës, zgjidhjen e martesës, përcaktimin e prindërit kujt i lihen fëmijët për rritje dhe edukim, përcaktimin e takimeve me fëmijët dhe e pensionit ushqimor për prindin tjetër, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit. Dispozitivi i vendimeve është i qartë dhe i plotë, duke përmbajtur të gjithë elementët e parashikuar nga ligji procedural civil dhe duke mos krijuar konfuzion për subjektet që do ta zbatojnë atë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha

dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mire përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mendimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Po ashtu, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e dokumentit ligjor” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIMIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me të tregues, vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore, aftësia për të identifikuar marrëdhënien shkak-pasojë si dhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre ose se si ato zbatohen mbi një situatë të caktuar, përmbajtja gjithëpërfshirëse e dokumentit ligjor si dhe evidentimi i nevojës për të njehsuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

Në tërësi, në dokumentet ligjore burim vlerësimi, rezulton se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhen me pretendimet e ngritura nga palët në rekurs, duke i analizuar ato në disa raste në mënyrë të përmbledhur dhe në formën e një konkluzioni dhe në disa raste të tjera komplekse në mënyrë më të detajuar, por në çdo rast në mënyrë logjike, koncize dhe të kuptueshme. Analiza e fakteve thelbësore apo çështjeve ligjore që janë bërë objekt rekursi, bëhet në disa raste duke integruar interpretimin dhe analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, në shërbim të konkluzionit të paraqitur që në pjesën hyrëse të mendimit të ndihmësit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjes, apo ngritjen e çështjeve për diskutim para Kolegjit. Spikat aftësia e ndihmësmagjistratës për të analizuar dhe argumentuar në mënyrë të qartë, të plotë dhe logjike në çështjet me karakter më kompleks, dhe konkretisht :

- (i) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 53201-00841-00-2012 ndaj të pandehurit GB, duke iu referuar shkaqeve të ngritura në rekurs, ndihmësmagjistratja ka referuar dhe

interpretuar dispozitat procedurale penale që lidhen me njoftimin (neni 140 i K.Pr.P), duke e analizuara atë në kontekstin e të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke zbatuar kështu parimi i kontradiktoritetit. Ndhmësmagjistratja ka arsyetuar se janë respektuar rregullat procedurale të parashikuara në këtë nen duke përshkruar në këtë rast hapat e ndjekura për njoftimin e të pandehurit të cilat kanë qenë sipas ligjit. Në këtë relacion ndihmësmagjistratja ka bërë interpretimin në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, duke dhënë mendimin e saj se gjykata kanë gabuar në cilësimin e veprës penale për sa kohë që nuk plotësohen elementët apo kushtet e ekzistencës së saj.

- (ii) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 56250-00893-00-2013 me të pandehur RD, ndihmësmagjistratja interpreton nenin 59 të K. Penal duke arsyetuar mbi pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në lidhje me kushtet e zbatimit duke qenë se i pandehur kishte një dënim të mëparshëm, për një vepër penale të kryer me dashje e në bashkëpunim. Në këtë rast ajo ka parashtruar përpara kolegjit çështjet për diskutim lidhur me rrezikshmërinë e të pandehurit kur ai ka qenë i dënuar më parë dhe kushtet që duhet të plotësohen për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.
- (iii) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 56430-01087-00-2012 me të pandehur KM, ndihmësmagjistratja interpreton nenin 3 të ligjit nr. 107/2012 «Për dhënie amnistie» duke arsyetuar mbi efektet e këtij ligji në rastin konkret kur vendimi i dënimit për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i K Penal «Largim nga vendi i aksidentit» ka marrë formë të prerë përpara hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar dhe si i tillë ajo është aministruar.
- (iv) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11243-02530-00-2012 me paditës shoqëria “Galina” dhe të paditurit shoqëria “Roal”, ndihmësmagjistratja interpreton nenin 143/2 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” lidhur me të drejtën e emrit tregtar, regjistrimin e markës duke e gjetur të pabazuar pretendimin e paditësit në lidhje me cënimin e emrit tregtar sepse referuar objektit të veprimtarisë, fusha e veprimit është shumë e gjërë dhe produktet që ai tregton janë të paregjistruara.
- (v) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11243-00225-00-2013 me paditës MB dhe të paditur Cez Shpërndarje ndihmësmagjistratja interpreton shfuqizimin e neneve 46/1 dhe pjesërisht të nenit 46/2/c të ligjit 9072/2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” nga ligji nr. 9997 datë 22.09.2008, i cili i heq të drejtën furnizuesve të marrin masa administrative (të vendosin gjoba) ndaj dëmit të shkaktuar nga marrja e paligjshme e energjisë elektrike duke vijuar me marrjen në analizë edhe të vendimit të ERE-s (vendim nr. 90, datë 15.11.2010) që ka monitoruar procedurat e ndjekura nga Cez Shpërndarje, duke konstatuar që aplikimi i “Dëmit ekonomik” apo “Energji e pamatur” është kryer në mënyrë abuzive dhe arbitrare pasi këto veprime nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke konkluduar në përfundim që vendimet e gjykatës janë rrjedhojë e interpretimit të drejtë të ligjit material.
- (vi) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11243-03063-00-2013 me paditës HM dhe të paditur HM, ndihmësmagjistratja citon nenet 371 dhe 379 të Kodit Civil që përcaktojnë personat që nuk mund të përjashtohen nga trashëgimia ligjore sikurse janë trashëgimtarët e paaftë për punë dhe kush quhen persona të paaftë për punë. Ajo analizon këto përkufizime duke i ndërthurur me provat dhe rrethanat e çështjes dhe del në konkluzionin që nuk është cënuar rezerva ligjore për sa kohë që në kohën e çeljes së trashëgimisë paditësi nuk e ka gëzuar statusin e personit të paaftë për punë. Gjithashtu ndihmësmagjistratja citon nenet 397 të KC dhe nenet 46, 47 të ligjit “Për noterinë” që lidhet me mënyrën e hartimit të testamentit dhe mënyrën e nënshkrimit të akteve dhe nga interpretimi i bërë duke i ndërthuar me provat shkresore del në konkluzionin që jemi para një akti absolutisht të pavlefshëm, pavlefshmëri e cila konstatohet

nga gjykata dhe nuk mund të ngrihet si padi më vetë konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik duke u bazuar edhe në interpretimin e Vendimit Unifikues nr. 5/2012.

(vii) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11241-01619-00-2013 me paditës ED dhe të paditur "KESH SECURITY SHRSF" sha, ndihmësmagjistratja interpreton nenet 140, 144, 153 dhe 155 të Kodit të Punës në lidhje me marrëdhënien e punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, procedura e zgjidhjes së saj nga punëdhënësi, zgjidhja e kontratës për shkaqe të justifikuara apo të pajustificuara dhe arsyeton duke i lidhur me rrethanat e faktit dhe arrin në konkluzionin që përderisa paditësi i ka përmbushur me përpikmëri të gjitha detyrimet e tij ligjore që burojnë nga kontrata individuale e punës dhe nuk ka kryer asnjë shkelje të rëndë apo të lehtë gjatë gjithë periudhës së punës, atëherë kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara dhe i padituri duhet të përgjigjet për pasojat.

(viii) Në relacionin që i përket çështjes civile me nr. 11117-02810-00-2013 me paditës AA, PD etj dhe të paditur VV dhe SV, ndihmësmagjistratja bën një interpretim të përgjithshëm mbi nenet 326, 327, 360, 361, 362 dhe 379 në lidhje me trashëgimin ligjore, përfituesit, zëvendësimin dhe rezervën ligjore të cilat i shtron për diskutim përpara Kolegjit duke e ndërthurur arsyetimin edhe në Vendimin nr. 1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara.

Në pjesën tjetër të dokumenteve ligjore të analizuara pavarësisht se mendimi i ndihmësit ligjor është paraqitur në mënyrë më të shkurtuar, shkalla e analizës dhe argumentimit logjik ka në çdo rast evident komponentin analitik i cili bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, shoqëruar një analizë paraprake se pse fakte të caktuara çojnë në këtë përfundim ligjor, pavarësisht paraqitjes së tyre në mënyrë të shkurtuar dhe më koncize, kushtëzuar kjo edhe nga natyra jo komplekse e çështjeve konkrete për të cilat konkludohet për mungesën e shkaqeve ligjore të rekursit.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve në rekurs, në dokumentet e analizuara, rezulton aftësia e ndihmësmagjistrates për të veçuar dhe përmbledhur shkakun ose shkaqet thelbësore të rekursit, si dhe për të analizuar kur është rasti, atë fakt apo pretendim që ka rëndësi thelbësore për zgjidhjen e çështjes apo në funksion të evidentimit të çështjeve të ngritura për diskutim prej saj.

Po ashtu, në vlerësimin e Kolegjit evidentohet edhe kontributi dhe aftësia në nivel maksimal e ndihmësmagjistrates në përgatitjen e projekt-vendimeve gjyqësore për çështjet e relatuar, referuar akteve të vlerësimit të Kolegjit në të cilat kjo aftësi vlerësohet maksimalisht dhe për pasojë do të konsiderohet në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

Në lidhje me treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik", në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet, ekzistenca e një cilësie të lartë të analizës ligjore, ndërthurjen e saj me faktet e çështjes, analiza tërësore e pretendimeve të palëve dhe arritja e konkluzioneve për zgjidhjen e çështjeve, mbi bazën e një argumentimi logjik të plotë dhe të qartë. Spikat aftësia e gjyqtarës në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar duke integruar në çdo rast provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit si dhe kategorisë së çështjes, analiza ligjore zhvillohet mbi bazën e një ecurie logjike, jepen argumente mbi ekzistencën dhe provueshmërinë e objektit kërkesë padie si dhe analizën mbi çdo pretendim të palëve, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe dhënien e argumenteve ligjore mënyrën e

aplikimit të tij mbi faktet konkrete. Karakteristike e arsytimit është kujdesi i gjyqtarës për të kuptuar qartë marrëdhëniet mes palëve ndërgjyqëse, të drejtat dhe detyrimet mes tyre, shkakut i vërtetë i ngritjes së padisë, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura. Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë në çdo rast pjesë e integruar e vendimit gjyqësor dhe merren në analizë më vete, të ndërthurura me analizën e provave dhe interpretimin e ligjit, në funksion të dhënies së një përgjigje të argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit pavarësisht se në masë të ndryshme, kushtëzuar na natyra komplekse ose jo e çështjes, rezulton e lartë. Evidentohet aftësia e ndihmësmagjistrates për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në rekurs si dhe dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural mbi këto fakte si dhe aftësia e saj për të evidentuar çështjet ligjore që duhet të vlerësohen nga Kolegji. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistrates, e vlerësuar kjo bashkë me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së saj në hartimin e projektvendimeve gjyqësore për çështjet e raportuara, vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues duhet të vlerësohet “shumë e lartë”. Në pikëzimin e këtij treguesi, konsiderohen edhe konkluzionet lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik në dy vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në të cilat rezultoi se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në këtë drejtim. Analiza dhe argumentimi logjik në vendimet gjyqësore përgjithësisht ndjek rregullin: rrethanë-normë-çështje-interpretim-konkluzion dhe argumentimi logjik ka vijueshmëri duke u evidentuar interpretimi individual i ligjit nga ana e saj. Arsytimi i vendimeve është shumë i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit”

Niveli e vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJITRATIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë e tij për të ndihmuar dhe kontribuar në mënyrë efektive në menaxhimin e çështjeve, nëpërmjet menaxhimit të kohës, planifikimin e çështjeve që ai përgatit për shqyrtim si dhe veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në Kolegj. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë ndihmësmagjistrati përdor kohën e tij në funksion të shqyrtimit të çështjeve nga Kolegji. Kjo aftësi vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. TREGUESI SASIOR NË PËRFUNDIMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e KLGJ-së për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit {...}, konkludohet se : ”...ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumenta ligjorë, rezulton se ndihmësja ligjore {...}, në periudhën 11.04.2014 – 16.09.2016 ka hartuar gjithsej 297 akte të relatimit të çështjeve (152 relacione me natyrë penale dhe 145 me natyrë civile), nga të cilat 1 relacion pranimi, 30 relacione “dërgim në gjyq” dhe 266 relacione mospranimi... në analizë të këtyre të dhënave, për të konkluduar mbi aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë duhen evidentuar tre faktorë (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përgatitor 20 çështje në muaj për relativitet, por referuar numrit prej 297 të çështjeve gjithsej për relativitet i janë caktuar, rezulton se rendimenti i punës së saj nuk përcaktohet i plotë për të përballuar ngarkesën në punë (ii) megjithatë kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarte minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; (iii) mungesa e të dhënave mi kohën e caktimit të çështjeve për relativitet dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësja ligjore, bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësës ligjore, të përzgjedhur me short për vlerësim”.

Në aktet e vlerësimit⁶⁵ të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet: “..E aftë dhe efektive në përgatitjen e relacioneve në aspektin sasior, duke realizuar numrin e

⁶⁵ Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 15, datë 26.02.2016, për periudhën prill 2014- prill 2015 dhe aktin me nr. 37, datë 28.07.2016, për periudhën prill 2015-prill 2016;

çështjeve prej 20 dosjeve të vendosur me Rregulloren e Gjykatës së Lartë dhe nën disa raste duke e tejkalar ashtu edhe në aspektin cilësor, duke dhënë mendime të argumentuara ligjërish për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve civile dhe penale. Për periudhën prill 2014- prill 2015 ka relatuar në total 180 penale⁶⁶ si dhe 40 çështje civile si dhe ka përgatitur projekt vendime civile dhe penale...gjithsej 50 projekt-vendime”, ”..Për periudhën maj 2015- maj 2016 ka relatuar në total 230 çështje civile si dhe ka përgatitur projekt vendime gjyqësore civilegjithsej 62 projekt-vendime”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit, referuar formatit të statistikave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për numrin e çështjeve të caktuara për relativ gjatë periudhës së vlerësimit por administrohen të dhëna vetëm për çështjet e përfunduara me vendim në Gjykatën e Lartë.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit kalimtar, si dhe të dhënave që rezultojnë për këtë tregues nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit⁶⁷, gjatë periudhës kohore nga data 11.04.2014-16.09.2016 (2 vite e 4 muaj apo 25 muaj, pa llogaritur muajt gusht të vitit 2014, 2015, 2016), rezultojnë të dhënat statistikore si më poshtë, për çdo vit kalendarik:

Për vitin 2014 (11.04.2014-31.12.2014), për një periudhë kohore prej 7 muaj (*duke mos përfshirë muajin gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore*), ndihmësmagjistratja {...} ka përfunduar dhe relatuar gjithsej **100 çështje**.

Për vitin 2015 (01.01.2015 -31.12.2015), për një periudhë kohore prej 11 muajsh (*duke mos përfshirë muajin gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore*), ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar si ndihmëse ligjore gjithsej **179 çështje**.

Për vitin 2016 (01.01.2016-16.09.2016), për një periudhë kohore prej 7 muaj ditë (*duke mos përfshirë muajin gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore*) ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar si ndihmëse ligjore gjithsej **18 çështje**.

Nga statistikat rezulton që ndihmësmagjistratja nuk ka përfunduar asnjë relacion në prill, qershor dhe korrik të vitit 2016 dhe vetëm një relacion në maj të atij viti.

Në total për periudhën 11.04.2014-16.09.2016, me një kohëzgjatje pune prej afërisht 25 muaj pune, ka përfunduar dhe relatuar **297 çështje**⁶⁸.

⁶⁶ Në muajin Mars 2015, gjyqtari Aleksander Muskaj pranë të cilit ka punuar ndihmësja ligjore ka ndryshuar Kolegj, duke kaluar nga Kolegji Penal në Kolegjin Civil, për këtë shkak një numër prej 16 dosjes janë përgatitur por kanë mbetur pa relatuar.

⁶⁷ Të dhënat statistikore lidhur me çështjet e relatuara dhe të përfunduara me vendim të Kolegjit Penal/Civil të Gjykatës së Lartë janë dërguar nga kjo gjykatë me shkresën nr. 430/1 prot., datë 27.02.2019 dhe administrohen në faqet 116-131 të dosjes së rielverësimit.

⁶⁸ Nga 297 relatime, 152 janë me natyrë penale dhe 145 me natyrë civile, nga këto 1 relacion pranimi, 30 relacione “dërgim në gjyq” dhe 266 relacione mospranimi.

Në formularin e vetvlerësimit profesional (shtojca 4), ndihmësmagjistratia ka deklaruar se *gjatë periudhës që ajo ka shërbyer si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, në periudhën Prill 2014- Shtator 2016 ka përgatitur 20 çështje në muaj për relativ, veç kësaj gjatë ushtrimit të kësaj detyre është përqëndruar kryesisht në përgatitjen e projektvendimeve gjyqësore sipas ngarkesës së gjyqtarit pranë të cilit ushtronte funksionin.*

Në akt vlerësimin e ndihmësit ligjor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për periudhën Maj 2015- Maj 2016, me nr.15 prot., datë 26.02.2016, rezulton se ndihmësmagjistratja është vlerësuar maksimalisht në të gjitha kriteret e vlerësimit, ku përfshihen dhe aftësitë organizuese. Konkretisht sa i përket aspektit sasior është shprehur në vlerësimin e saj Kolegji është shprehur se:*E aftë dhe efektive në përgatitjen e relacioneve të çështjeve si në aspektin sasior, duke realizuar numrin e çështjeve prej 20 dosjve të vendosura në rregulloren e Gjykatës së Lartë dhe në ëdisa rsate duke e tejkaluar ashtu edhe në aspektin cilësor, duke dhënë mendime të argumentuara ligjerisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve civile dhe penale. Për periudhën Prill 2014- Prill 2015 ka relatuar në total 180 çështje penale⁶⁹, si dhe 40 çështje civile, ka përgatitur projekt vendime gjyqësore civile, çështje themeli, rishikime, kompetenca dhe juridiksione që ka pasur në ngarkesë gjyqtari pranë të cilit ushtron funksionin, gjithësej 50 projekt- vendime.*

Në akt vlerësimin e ndihmësit ligjor të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për periudhën Maj 2015- Maj 2016, me nr.37 prot., datë 28.07.2016, rezulton se ndihmësmagjistratja është vlerësuar maksimalisht për të gjitha kriteret e vlerësimit. Sa i përket aspektit sasior në akt vlerësimin Kolegji është shprehur se:*E aftë dhe efektive në përgatitjen e relacioneve të çështjeve si në aspektin sasior, duke realizuar numrin e çështjeve prej 20 dosjve të vendosura në rregulloren e Gjykatës së Lartë dhe në ëdisa rsate duke e tejkaluar ashtu edhe në aspektin cilësor, duke dhënë mendime të argumentuara ligjerisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve civile dhe penale. Për periudhën Maj 2015- Maj 2016 ka relatuar në total 230 çështje civile, ka përgatitur projekt vendime gjyqësore civile, çështje themeli, rishikime, kompetenca dhe juridiksione që ka pasur në ngarkesë gjyqtari pranë të cilit ushtron funksionin, gjithësej 62 projekt- vendime.*

Referuar mospërputhje midis të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Lartë, me dy aktet e vlerësimit të kryera nga Kolegjet përkatëse të kësaj gjykate, që lidhen me të dhënat statistikore, konkretisht me numrin e relacioneve dhe punën e kryer nga ndihmësmagjistratja, u vlerësua e nevojshme për t'iu drejtuar me shkresë Gjykatës së Lartë, për të saktësuar të dhënat lidhur me volumin e punës së ndihmës magjistrates {...}, pra të saktësohej numri i çështjeve të përgatitura dhe të relatuara, si dhe ato të përgatitura por të paretuara.

Nëpërmjet shkresës me nr.5489 pot., datë 17.10.2022, e protokolluar në Këshill me nr.5472, datë 17.10.2022, Gjykata e Lartë ka sqaruar se ; *Nga aktet e dërguara në kuadër të procedurës së vlerësimit të nisur për gjyqtaren/ndihmësmagjistraten {...}, ka rezultuar një mospërputhje midis të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Lartë dhe të dhënave statistikore të përdorura*

⁶⁹Sipas aktit të vlerësimit, rezulton se në muajin Mars 2015 gjyqtari Aleksandër Muskaj pranë të cilit ka punuar ndihmësi ligjor/ ndihmësmagjistratja {...}, ka ndryshuar Kolegji, duke kaluar nga Kolegji Pnal në Kolegjin Civil dhe për këtë shkak një numër prej 16 dosjes janë përgatitur, por kanë mbetur të paretuara.

për hartimin e dy akteve të vlerësimit të kryera nga Kolegjet përkatëse të kësaj gjykate. Konkretisht, nëpërmjet shkresës me nr. 430/1 prot., datë 27.02.2019 të Gjykatës së Lartë janë dërguar statistikat përkatëse për Znj. {...}, në format tabelare sipas tabelës nr.7, sipas të cilës rezulton se gjatë kësaj periudhe ajo ka relatuar 297 çështje të Kolegjit Penal dhe Civil. Në lidhje me këtë fakt, ju bëjmë me dije se ky numër përfshin vetëm relacionet që janë loguar në emrin e këshilltares ligjore në sistemin ICMIS të Gjykatës së Lartë dhe të verifikuara e dhenë regjistrat manuale të numërtimeve të dosjeve gjyqësore të përfunduara me vendim si dhe nuk janë të përfshirë çështjet me pezullime ekzekutim vendimi (këto lloj çështje janë të regjistruara në libra manual).

Po ashtu në statistikën e dërguar nga ana jonë nuk janë përfshirë relacionet e përgatitura dhe të paretuara nga këshilltari ligjor. Ndaj vlerësojmë se ka mospërputhje mes vlerësimit të kolegjeve civile dhe penal për periudhën e sipërpërmendur dhe statistikave të dërguara nga ana jonë me shkresën nr. 430/41 prot, datë 27.02.2019.

Sjellim në vëmendje që GMC përbëhet nga gjyqtari relator si dhe 2 ndihmësit ligjore, në rastin {...} dhe Alfred Balla, të cilët referuar regullimeve të Gjykatës së Lartë përpjestonin me njeri -tjetrin ngarkesën e çështjeve të gjyqtarit relator.

Ju informojmë se gjatë periudhës prill 2014- 16 shtator 2016 gjyqtari/relator Aleksandër Muskaj ka marrë 943 vendime për çështjet civile dhe penale (çështje të regjistruara në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të relatuar nga ndihmësit ligjor {...} dhe Alfred Balla), 2 vendime të Kolegjeve të Bashkuara si dhe 145 vendime për çështje me kërkesë pezullim ekzekutim vendimi. Për shkak të pamundësisë objektive për të përcjellë pranë Jush numrin e saktë të relitimeve të ndihmësit ligjor {...}j, po ju përcjellim numrin e çështjeve (civile dhe penale) të përfunduara me vendim nga gjyqtari/relator Aleksandër Muskaj.

Referuar të dhënave statistikore⁷⁰ për numrin e çështjeve të përfunduara me vendim nga gjyqtari/relatori Aleksandër Muskaj pranë të cilit është caktuar ndihmësi ligjor {...}, rezulton se periudhën 11 Prill 2014- 14 Korrik 2016 ai ka dhënë 942 vendime penale e civile.

Për vitin 2014 (11.04.2014-31.12.2014), për një periudhë kohore prej 7 muaj (duke mos përfshirë muajin gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore), gjyqtari ka përfunduar gjithsej **313 çështje**.

Për vitin 2015 (01.01.2015 -31.12.2015), për një periudhë kohore prej 11 muajsh (duke mos përfshirë muajin gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore), gjyqtari ka përfunduar gjithsej **442 çështje**.

Për vitin 2016 (01.01.2016-14.07.2016), për një periudhë kohore prej 6 muaj e 14 ditë ë (duke mos përfshirë muajin gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore), gjyqtari ka përfunduar gjithsej **188 çështje**.

Në këto të dhëna nuk janë përfshirë vendimet për çështjet me kërkesë pezullim ekzekutimi vendimi të cilat janë rreth 145 vendime për të gjithë këtë periudhë.

⁷⁰ Të dërguar me shkresën me nr.5489 prot., datë 17.10.2022 të Gjykatës së Lartë.

Për pasojë në total, numri i çështjeve të përfunduara me vendim nga gjyqtari Aleksandër Muskaj për periudhën e vlerësimit të ndihmësmagjistrates {...}j është gjithësej 1087 çështje. Duke u nisur nga fakti se puna midis dy ndihmësve ligjore është përpjestuar në mënyrë të drejtë, dhe sipas dy vlerësimeve të bërë për ndihmësen nga Kolegji Penal e Civil i Gjykatës së Lartë rezulton se ajo jo vetëm e ka plotësuar numrin e 20 çështjeve të relatuar të përcaktuar në Rregulloren e Gjykatës së Lartë por edhe e ka tejkaluar, rezulton se përgjatë periudhës së vlerësimit nga data 11.04.2014 deri në datën kur gjyqtari ka dhënë vendimi, datë 14.07.2016, e cila është rreth 25 muaj, ajo ka relatuar afërsisht rreth 543,5 çështje, pra mesatarisht rreth 21.74 çështje në muaj, duke e tejkaluar standardin e përcaktuar në Rregullon e Gjykatës së Lartë.

Në dosjen e rivlerësimit nuk administrohen të dhëna statistikore për çështjet e përgatitura por të pa relatuar gjatë periudhës përkatëse dhe kjo e dhënë nuk mund të gjenerohet, referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale dhe as statistikave të dërguara nga Gjykata e Lartë. Por referuar dy vlerësimeve të ndihmësmagjistrates të bëra nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, për periudhën 11 Prill 2014- 11 Prill 2015, rezulton se për 16 dosje ndihmës magjistratja ka përgatitur relacionet të cilat nuk janë relatuar për shkak se në muajin Mars të vitit 2015, gjyqtari Aleksander Muskaj pranë të cilit ka punuar ndihmësja ligjore ka ndryshuar Kolegj, duke kaluar nga Kolegji Penal në Kolegjin Civil, numër i cili i shtohet numrit të përgjithshëm të dosjeve të relatuar prej saj, duke e tejkaluar kështu për çdo muaj standardin e përcaktuar për numrin e relacioneve që duhet të përgatisë çdo ndihmës ligjor.

Sa i përket standardit sasior të punës së ndihmësmagjistratit, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky tregues pikëzohet duke iu referuar aftësisë së ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë sipas një standardi minimal të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh. Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se nuk ka pasur standard sasior të miratuar për çdo kategori çështjesh. I vetmi parashikim lidhur me këtë aspekt është ai i nenit 25, pika 2 të “Rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë”, në të cilin parashikohet se : *“Çdo ndihmës ligjor i Gjykatës së Lartë përgatit për relativitet jo më pas se 20 (njëzet) dosje në muaj.”*

Duke iu referuar këtij parashikimi të Rregullores dhe të dhënave statistikore të administruara, të cilat paraqesin ngarkesën e gjyqtarit Aleksandër Muskaj në kushtet kur të dhënat e mëparshme statistikore nuk pasqyrojnë punën e saktë të ndihmësmagjistrates, rezulton se gjatë periudhës 11.04.2014-16.09.2016, duke përfshirë muajt gusht 2014, 2015 dhe 2016, gjatë të cilëve zhvillohet leja vjetore por dhe periudhën nga data 15 Korrik deri në 16 Shtator kur gjyqtari nuk ka dhënë asnjë vendim, rezulton se për këtë periudhë, ndihmësmagjistratja {...} ka përgatitur për afërsisht 543,5 çështje, për të cilat gjyqtari ka marrë vendim, pra mesatarisht rreth 21.74 çështje në muaj, mbi standardin minimal të miratuar; **Po të shtojmë këtu edhe numrin e çështjeve të cilat rezultojnë të përlatuar gjatë vitit 2015, prej 16 relacione, rezulton se ajo ka relatuar mesatarisht rreth 22.36 çështje në muaj, pra mbi standardin minimal të miratuar.**

Edhe po t'i referohemi, periudhës për të cilën ka të dhëna lidhur me numrin e relacioneve të përgatitura nga ndihmësja ligjore {...}, referuar dy vlerësimeve të bërë nga Kolegji Penal dhe Civil i Gjykatës së Lartë, për periudhën prill 2014 (11 prill 2015)- prill 2015 si dhe Maj 2015- Maj 2016, rezulton se ajo ka relatuar në total 180 penale si dhe 40 çështje civile, dhe 16 çështje kanë ngelur pa relatuar për periudhën e parë, dhe për maj 2015- maj 2016 ka relatuar në total 230, pra në total për këtë periudhë 22 mujore (duke hequr muajin gusht të vitit 2014 dhe 2015)

ajo ka përgatitur 466 relacione, mesatarisht 21.2 relacione në muaj, mbi standardin minimal.

Për sa më sipër, për të gjithë periudhën e vlerësimit të gjyqtares si ndihmësmagjistrate, rezulton të ketë përgatitur afërsisht 543,5, çështje të cilat kanë përfunduar me vendimi ose rreth 22 çështje në muaj, e dhënë që përputhen afërsisht edhe me të dhënat e pasqyryar në dy Aktvlerësimit e bërë për gjyqtaren nga Kolegji Penal dhe Civil i Gjykatës së Lartë për periudhën prill 2014 – maj 2016.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësja ligjore {...} ka përgatitur për relativ mesatarisht 22 çështje në muaj, duke tejkaluar mesatarisht me 2/çështje në muaj ose me 10 % standardin sasior në fuqi prej 20 çështjesh në muaj.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me treguesin sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore, është “mbi standard” dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.A.B. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, nuk ka të dhëna për treguesin e rendimentit gjatë ushtrimit të funksionit si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë për shkak të mungesës së të dhënave burimore mbi numrin e çështjeve të caktuara për të njëjtën periudhë.

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna.

Pavarësisht se në tabelat me të dhëna statistikore nuk administrohen të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara për relativ për çdo vit kalendarik dhe as për të gjithë periudhën e vlerësimit në tërësi, llogaritja e rendimentit të përfundimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit, do të bazohet në metodologjinë e mëposhtme :

Referuar standardit sasior në fuqi, në periudhën e vlerësimit, ndihmës magjistratit duhet t'i jenë caktuar për trajtim (*përgatitje për relativ*) së paku 20 çështje në muaj, pra në total për periudhën e ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor prej 25 muaj, duhet t'i jenë caktuar 500 çështje. Rendimenti i matur si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (e cila rezulton afërsisht 543,5 çështje të përfunduara me vendim dhe 16 çështje të pa relatuar) me ato të caktuara, si më sipër, në këtë rast rezulton 118 % që sipas metodologjisë përkon me përkon me 15 pikë duke qenë se rezulton +99 %.

KONKLUZIONI

Pavarësisht analizës së mësipërme statistikore, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga analiza logjike e gjithë ngarkesës së punës së ndihmësmagjistrates, vlerësohet se pikëzimi për këtë tregues duhet të jetë 15 pikë, pasi rezulton se ajo ka tejkaluar standardin sasior dhe rezulton me një rendiment prej 118 %.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore", ndihmësmagjistratja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi rendimenti i saj është mbi 99 %.

2.B. AFTËSIA PËR TË PËRFUNDUAR NË KOHË ÇËSHTJET E NGARKUARA

2.B.A. RESPEKTIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se "Në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, referuar dokumentit nr. 2 të analizuar në aktin e KLGJ-së, në të cilin ky i fundit ka parashtruar se: "Nuk është pasqyruar data e regjistrimit të çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohet kohëzgjatja e gjykimit të saj", Komisioni, pas shqyrtimit të vendimi nr. ***, datë 17.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka arritur në konkluzionin se ky vendim i përket çështjes së regjistruar në datën 7.2.2014, pranë kësaj gjykate dhe kohëzgjatja e gjykimit ka rezultuar brenda afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa "e", e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Në lidhje me mosvendosjen e datës së përpilimit të relacionit nga ndihmësligjori, nuk ka rezultuar ndonjë përcaktim ligjor apo format standard për përpilimin e tyre dhe as ndonjë përcaktim specifik në rregulloren e brendshme të

institucionit. Për rrjedhojë, lidhur me këtë konstatim, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit..”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përgatitur dokumentin ligjor brenda standardit minimal kohor të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh, si raport mes numrit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjore janë përgatitur tej standardit, me numrin total të çështjeve të përgatitura.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna për të mundësuar përlllogaritjen e kohës së përgatitjes së dokumenteve ligjore. Po ashtu në periudhën e vlerësimit nuk rezulton që kuadri ligjor dhe nënligjor të kishte të përcaktuar kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor.

Dokumentet ligjore të përzgjedhura me short për vlerësim nuk përmbajnë datën të hartimit të tyre. Po ashtu, aktet e dosjeve për këto çështje nuk përmbajnë asnjë të dhënë për datën e caktimit dhe datën e përfundimit të dokumentit ligjor (relacionit) nga ana e ndihmësmagjistratit.

Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë⁷¹, në nenin 15 pika, 1 dhe 2 parashikon se: *”1. Mbledhja e kolegjit në dhomë këshillimi për shqyrtimin e rekursit zhvillohet në datat e caktuara nga kryetari i Kolegjit, pas konsultimit në anëtarët e tjerë të Kolegjit respektiv. 2.Ndihmësi ligjor i gjyqtarit relator duhet të ketë shpërndarë më parë për studim relacionin dhe materialet e tjera ndihmëse...”.* Referuar këtij parashikimi, në mungesë të të dhënave për datën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor për përgatitjen e relacionit dhe për datën e përfundimit të tij, si dhe në mungesë të të dhënave për datën e caktimit e seancës për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, prezumohet se relacioni është përgatitur nga ndihmësi ligjor para datës së relatimit të tij para Kolegjit, brenda standardeve kohore të arsyeshme.

Nga çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, sa i përket kohëzgjatjes së përgatitjes së relacionit, duke iu referuar arsytimit si më sipër, rezulton se:

- i) Çështja çështjes civile me nr. 11243-02530-00-2012 me paditës shoqëria “Galina” dhe të paditurit shoqëria “Roal”, me objekt “Deklarimin e pavlefshmërisë së markës së regjistruar”, është regjistruar me datë 27.09.2012, përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 505, datë 09.12.2015. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 09.12.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.****
- ii) Çështja civile me nr. 230000-01017-2013 me paditës shoqëria EZh dhe të paditurit DhZh”, me objekt “Pjestim i pasurisë së paluajtshme” është regjistruar me datë 09.04.2013 dhe shqyrtuar në dhomë këshillimi me datë 21.07.2015, përfunduar me*

⁷¹Rregullore e miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

- vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 298, datë 27.01.2016. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 21.07.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***
- iii) Çështja civile me nr. 11117-02810-00-2013 me paditës AA, PD etj dhe të paditur VV dhe SV, me objekt “Pavlefshmëri absolute e testamentit” regjistruar me datë 27.09.2012, shqyrtuar në dhomë këshillimi datë 04.12.2015, përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 463, datë 19.04.2018. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 04.12.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.**
- iv) Çështja civile me nr. 31003-03561-00-2013 me paditës EH dhe të paditur “Ujësjellës - Fshat” sha Korçë, me objekt “Pavlefshmëri absolute e testamentit” regjistruar me datë 27.09.2012, shqyrtuar në dhomë këshillimi datë 17.02.2016, përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1776, datë 18.05.2016. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 17.02.2016. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.**
- v) Çështja penale me nr. 56430-01087-00-2012 me të pandehur KM, akuzuar për “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Largimit nga vendi i aksidentit”, regjistruar më datë 01.08.2012, përfunduar me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 1204, datë 19.09.2014. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 19.09.2014. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.**

Në relacionin e përzgjedhur nga vetë ndihmësmagjistratja, rezulton si më poshtë:

- vi) Çështja civile me nr. 11243-03063-00-2013 me paditës HM dhe të paditur HM, me objekt “Deklarimin e pavlefshëm të testamentit” përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 2185, datë 28.01.2016. Relacioni i përhatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para përfundimit të çështjes në datë 28.01.2016. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.**

Në gjashtë çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, nga aktet e dosjeve të administruara, rezulton si më poshtë:

- vii) Çështja penale me nr, akti 52303-01532-00-2012, me të pandehur Denis Turku, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Plagosjes së rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, regjistruar më datë 19.11.2012, përfunduar me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-1427, datë 02.10.2014. Relacioni i përhatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para përfundimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 02.10.2014. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.**
- viii) Çështja penale me nr, akti 53201-00841-00-2012, me të pandehur GB, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, regjistruar më 11.06.2012, përfunduar me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-1088, datë 04.07.2014. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet,** por prezumohet që relacioni është përgatitur para datës 04.07.2014, datë në të cilën çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi.
- ix) Çështja penale me nr. akti 56250-00893-00-2013, me të pandehur RD, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, regjistruar më datë 18.07.2013 përfunduar me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-699, datë 26.02.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet,** por prezumohet që relacioni është përgatitur para datës 26.02.2015, datë në të cilën çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi.
- x) Çështja civile me nr. akti 11243-00225-00-2013, me palë paditëse MB, palë e paditur Cez shpërndarje Tiranë (ish OSSH Fier), me objekt “Pavlefshmëri të pjesshme të titullit ekzekutiv – faturë shitje të energjisë elektrike”, regjistruar më datë 25.01.2013 përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-2665, datë 21.07.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet,** por prezumohet që relacioni është përgatitur para datës 21.07.2015, datë në të cilën çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi.
- xi) Çështja civile me nr. akti 11118-02240-00-2013 , me palë paditëse AL, palë e paditur Shoqëria “TIRKA 2000” shpk , me objekt “Detyrimin e palës së paditur për t’i paguar paditësit dëmin e shkaktuar në masën prej 1.438.300”, përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2017-2188, datë 09.11.2017. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet,** por prezumohet që relacioni është përgatitur para datës 09.11.2017, datë në të cilën çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi.
- xii) Çështja civile me nr. akti 11241-01517-00-2014, me palë paditëse Elidon Dako, palë e paditur “KESH SECURITY” SHRFS , me objekt “Detyrim për pagimin e dëmshpërblimit për largimin nga puna në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara përkatësisht: Pagën e nje viti punë për zgjidhje të menjëhershme dhe të

*pajustificuar të kontratës së punës”, rezulton e regjistruar më datë 02.05.2014 dhe përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2016-2185, datë 28.01.2016. **Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet,** por prezumohet që relacioni është përgatitur para datës 28.01.2016, datë në të cilën çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi.*

Në tërësi për 12 çështjet e analizuara, në asnjë prej tyre nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor, pasi mungojnë edhe të dhënat për datën e dorëzimit të dosjes ndihmësmagjistrates me qëllim përgatitjen e relacionit si dhe kohën e vënies në lëvizje të dosjes nga gjyqtari relator nëpërmjet vendimit për caktimin e seancës. Për pasojë, përlllogaritja e kohës së mundshme të përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor është e pamundur dhe do të vlerësohet se ato janë përgatitur duke respektuar afatin e vënë nga gjyqtari relator, referuar kjo edhe vlerësimeve të Kolegjit për këtë aspekt.

Burim vlerësimi janë dhe dy vendimet gjyqësore të zgjedhura nga ndihmësmagjistratja në procedurën e vlerësimit kalimtar, të cilat rezultojnë se kanë përfunduar brenda standardit minimal të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së, prej 4 dhe 6 muajsh, referuar datës së regjistrimit të çështjeve dhe datës së dhënies së vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistrati në periudhën e vlerësimit si dhe në pamundësi të përlllogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 12 çështjet e analizuara, faktin se dy çështjet gjyqësore kur ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtares kanë përfunduar në kohë, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë.*

2.B.B. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE TË PËRGATITUR PËR RELATIM

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;

- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues.

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet, sikurse për treguesin e mësipërm, se : *”..E aftë për të përgatitur relacionet e çështjeve, që i janë caktuar gjyqtarit nëpërmjet shortit elektronik, brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjyqtari pranë të cilit punon, bazuar edhe në kriteret e përcaktuara në rregulloren e Gjykatës”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi përlllogaritet koha mesatare që i dedikohet përpunimit të dokumenteve ligjore për çdo çështje, krahasuar me standardet kohore të përcaktuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për çdo kategori çështjesh.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, për përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje sipas kategorive, evidentohen disa elementë që nuk mundësojnë përlllogaritjen e saj, si më poshtë:

- Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk rezultojnë standarde kohore të miratuara për përgatitjen e dokumentit ligjor nga ndihmësmagjistratja, për kategori çështjesh, dhe as për çështjet në tërësi;
- Të dhënat statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit nuk i diferencojnë çështjet në kategori dhe nuk përmbajnë informacion për kohën e hartimit të dokumentit ligjor;
- Të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për 12 çështjet e përzgjedhura me short nuk mundësojnë përlllogaritjen e kohës mesatare të përgatitjes së dokumentit ligjor për kategori çështjesh;
- Mungesë të dhënash për përlllogaritjen e përafërt të kohës së përgatitjes së dokumentit ligjor duke iu referuar kohës së vënies në lëvizje të çështjes nga gjyqtari realator deri në momentin e relatimit, pasi në dosjet gjyqësore të administruara nuk ka vendim për kalimin e çështjes në seancë në dhomë këshillimi.

Sa më sipër, duke konsideruar mungesën e të dhënave në raport me vlerësimin e kolegjit të kryer për ndihmësmagjistraten gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës, vlerësoj se koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor për kategori çështjes është në pamundësi objektive të përlllogaritjet dhe për këtë arsye do të vlerësohet dhe pikëzohet në nivel maksimal.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitet dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistratja në periudhën e vlerësimit si dhe pamundësisë objektive të përlllogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 12 çështjet e

analizuara, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të përgatitur për relativim” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 20 pikë.

2.C. METODOLOGJIA E PUNËS

2.C.A AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR E KRYER VEPRIMET E NEVOJSHME DHE SHMANGIEN E VEPRIMEVE JOPRODUKTIVE NË FUNKSION TË ORGANIZIMIT TË PROCESIT GJYQËSOR

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, sa i përket këtij treguesi, i cili në raportin analitik titullohet “Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, është konkluduar se:”Nga të gjitha praktikatat e administruara, nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e 6 dhe 8 dokumentet ligjore, konstatohet në çdo rast, ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore dhe e ka relatuar për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulta, thelbim e analizës ligjore si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementët proceduralë të kërkuara në nenin 21 të Ligjit Nr.8588, datë 15.03.200 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë.”dhe nenin 25 të Rregullores së brendshme të Gjykatës së lartë të miratuar me udhërin nr.214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të kësaj gjykate.

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : ”E aftë për të ndihmuar gjyqtarin në planifikimin e seancave gjyqësore, të dosjeve gjyqësore që kanë kaluar për gjykim, duke dhënë edhe mendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.⁷²”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 12 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim nuk rezultojnë të dhëna konkrete sa i përket ndihmësës dhe kontributit të ndihmësit ligjor në drejtim të respektimit të rendit kronologjik të çështjeve për t’u përgatitur në përputhje me afatet ligjore, respektimin e afateve të

⁷² Ky konkluzion është i njëjtë në të dy aktet e vlerësimit nga Kolegji Penal dhe Civil të Gjykatës së Lartë për periudhat Prill 2014- Prill 2015 dhe Maj 2015- Maj 2016.

përcaktuara nga gjyqtari relator ose Kolegji, kryerjen e veprimeve efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës, planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore ose në dhomë këshillimi, kryerjen në kohë të njoftimeve/shpalljeve, dokumentimin e vendimeve ose veprimeve të tjera procedurale, ndjekjen e seancave apo diskutimeve për çështjet si dhe ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve.

Në dosjet gjyqësore të cilat i përkasin çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim administrohen të plota aktet e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, duke përfshirë sipas rastit rekursin, relacionin e ndihmësit ligjor, procesverbalet e seancave dhe njoftimet në rastet kur çështja është kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, aktet shkresore dhe qëndrimet me shkrim të palëve ndërgjyqëse, si dhe vendimi gjyqësor në dhomë këshillimi dhe/ose seancë gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 12 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim rezulton se çështjet e shqyrtuar në dhomë këshillimi kanë përfunduar në seancën e caktuar dhe njoftimet e palëve megjithëse nuk janë administruar në dosje, rezulton të jenë relatuar në relacionin e ndihmësit ligjor si të verifikuara. Për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore, rezulton që njoftimet e urdhëruara nga gjyqtari relator ose trupi gjykues në seancë gjyqësore, janë kryer dhe administruar në dosje. Nuk rezulton që ndonjë nga seancat gjyqësore të ketë dështuar për moskryerjen e njoftimeve efektive. Ky element në mënyrë të tërthortë tregon se ndihmësi ligjor ka kontribuar në mënyrë efektive për kryerjen e njoftimeve/shpalljeve në kohë dhe me efektivitet.

Në mungesë të të dhënave konkrete lidhur me aspektet që shërbejnë për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme procedurale dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor nga ana e ndihmëses ligjore, si dhe duke u bazuar në mendimin e Kolegjit Penal/Civil, i cili në të gjitha aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor, ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e saj në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe mungesës së të dhënave konkrete lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësja ligjore në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, vlerësohet se aftësitë e ndihmësmagjistrates për këtë tregues janë shumë të larta dhe duhet pikëzohen maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproductive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.C.B AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR BRENDA ÇËSHTJEVE TË CAKTUARA PËR RELATIM, ATO QË KËRKOJNË VËMËNDJE TË POSAÇME DHE QË DUHET TË TRAJTOHEN ME PËRPARËSI, PËR SHKAK TË KËRKESAVE PROCEDURALE

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues por për aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore, konkludohet siç është parashtruar në treguesin më sipër.

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *”E aftë për të ndihmuar gjyqtarin në planifikimin e seancave gjyqësore, të dosjeve gjyqësore që kanë kaluar për gjykim, duke dhënë edhe mendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.”⁷³*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 12 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton asnjë çështje e cila duhet të trajtohet me përparësi për shkak të afatit ligjor të shqyrtimit.

Po ashtu, në aktet e vlerësimit të kolegjit, sa i përket aftësive të ndihmëses ligjore lidhur me këtë tregues nuk ka të dhëna specifike, por aftësitë organizative në drejtim të metodologjisë dhe menaxhimit të kohës, janë vlerësuar maksimalisht.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit sa i përket aspekteve për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar çështjet që kërkojnë vëmendje të posaçme, referuar të dhënave që rezultojnë nga çështja e përzgjedhur me short relatuar më sipër, si dhe duke konsideruar vlerësimet e Kolegjit Penal/Civil i cili ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e ndihmëses ligjore në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, rezulton se aftësitë e saj në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

KONKLUZIONI

⁷³ Ky konkluzion është i njëjtë në të dy aktet e vlerësimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe vlerësimeve të Kolegjit, rezulton se ndihmësja ligjore ka treguar aftësi shumë të larta në evidentimin dhe përgatitjen për relativitet të të gjitha çështjeve për të cilat ligji procedural ka parashikuar afate ligjore shqyrtimi. Për këtë arsye vlerësohet se aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe duhet të pikëzohen maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

2.C.C. RREGULLSHMËRIA, SAKTËSIA E PLOTËSIA E DOSJES GJYQËSORE

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” Në lidhje me detyrën e ndihmësligjorit të kryer nga znj. {...} në Gjykatën e Lartë, në aktvlerësimet e kësaj të fundit, kryer për periudhat Prill 2014 - Prill 2015 dhe Maj 2015 - Maj 2016, evidentohet fakti se subjekti i rivlerësimit jep mendime të argumentuara ligjërisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Znj. {...} është vlerësuar nga Gjykata e Lartë se është e aftë të shkruajë thjesht dhe qartë projektvendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë...”.

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet sic është referuar më sipër në raportin analitik të rivlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 11 çështjet e përzgjedhura me short, gjatë dhe pas fillimit të procedurës së vlerësimit, janë administruar fashikujt e plotë të çështjeve të cilat i përkasin dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim.

Në tërësi, nga 11 çështje të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se në të gjitha dosjet administrohet relacioni i përgatitur nga ndihmësja ligjore. Po ashtu në dosje administrohen të gjitha aktet e fashikullit të formuar në Gjykatën e Lartë, të cilat sipas ritualit të shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore, përmbajnë:

- (i) Në dosjet për të cilat shqyrtimi ka përfunduar në dhomë këshillimi administrohen : *relacioni i ndihmësit ligjor dhe vendimi i Kolegjit Penal në dhomë këshillimi* ;
- (ii) Në dosjet për të cilat shqyrtimi ka përfunduar në seancë gjyqësore, administrohen : *relacioni i ndihmësit ligjor, vendimi i Kolegjit Penal në dhomë këshillimi, njoftimet, procesverbalet e seancave sipas datave, konkluzionet dhe qëndrimet me shkrim të palëve dhe vendimi i Kolegjit Penal në seancë gjyqësore.*

Nuk evidentohet përfshirja në dosje e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Të gjitha dosjet e administruara paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të renditura kryesisht në mënyrë kronologjike dhe mund të shfrytëzohen pa vështirësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë në çdo rast të rregullta, të sakta dhe të plota, duke përfshirë edhe relacionin e hartuar nga ndihmësi ligjor dhe çdo akt që i përket fashikullit të Gjykatës së Lartë. Shkalla e kujdesit të ndihmësmagjistrates është e lartë si në drejtim të përmbajtjes së fashikullit, të renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera me qëllim që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, është edhe në drejtim të mbikëqyrjes së procesit administruar të dokumentacionit në dosje, duke i dorëzuar aktet e përgatitura prej saj dhe duke i administruar ato në fashikullin e gjykimit. Për këtë arsye, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues është “Shumë e lartë”.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në treguesin “Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit”.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, pavarësisht institucionit ku kontribuon, është së pari gjyqtar dhe për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo

ndihmësmagjistrat e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë aspekt, në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “...Sipas të dhënave nga databaza e ankesave dhe fundi arkivor i KLGJ, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit ”8 tetor 2013- 8 tetor 2016” për gjyqtaren {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish KLDH. Edhe sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Edhe nga vëzhgimi i 5 dokumenteve të përzgjedhura, nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit {...}.”

Në aktet e vlerësimit profesional të Kolegjit, lidhur me etikën në punë, konkludohet se: “Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe kryetarin e gjykatës, si gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij. Respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës.”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, sipas raportit analitik të rivlerësimit, rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj saj nuk janë paraqitur ankesa.

Referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 453, datë 27.09.2021, rezulton se ndaj saj janë paraqitur 9 ankesa, të cilat nuk i përkasin periudhës së vlerësimit Tetor 2013- Tetor 2016. Megjithatë ankesat janë trajtuar nga KPK dhe nga të dhënat e referuara nuk rezultojnë asnjë element që mund të vlerësohet në drejtim të etikës në punë të gjyqtares. Ankesat kryesisht konsistojnë në pretendime mbi vendimmarrjen apo procedurat gjyqësore, të cilat pasi janë trajtuar janë gjetur të pabazuara nga KPK. Megjithatë ky përfundim mund të përdoret në periudhën tjetër të vlerësimit të gjyqtares, 2017-2019 në kushtet kur ankesat lidhen me këtë periudhë.

Nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në proces, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e Znj. {...} gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës së ndihmësës ligjore në Gjykatën e Lartë dhe detyrës së gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësës ligjore në Gjykatën e Lartë, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së ndihmësmagjistrates në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI

Lidhur me këtë aspekt, në raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të hartuar nga KLGJ, konkludohet se: “Nga dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dokumentat e vëzhguara, nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të Kolegjit nuk ka të dhëna apo vlerësim të drejtpërdrejtë sa i përket aspektit të integritetit.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësës ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Nga të dhënat arkivore të KLD/KLGJ rezulton se ndaj saj nuk janë paraqitur ankesa gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. {...} ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar, ku rezultoi të ishte e përfshirë...Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...}: a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë..”*

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sa i përket vlerësimit të figurës dhe aftësive profesionale, konkludohet se: *“... Për rrjedhojë, në vijim të komunikimeve me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, për sa kohë nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit, lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga Grupi i Punës, pranë DSIK-së, edhe trupi gjykues e vlerëson subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për të vijuar detyrën e gjyqtares... Trupi gjykues, në këto kushte, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se nuk kanë rezultuar shkelje të rënda të subjektit, trupi gjykues çmon se referuar nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit {...} është e aftë dhe ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse. Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...}: ... b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioni, në këto kushte, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit {...}, duhet të konfirmohet në detyrë....”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të ndihmësmagjistrates.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e ndihmësmagjistrates.

Shkalla e integritetit të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të ndihmësmagjistrates në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA

Lidhur me këtë aspekt në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në 3 dokumentat ligjore të përzgjedhura dhe 5 dokumentat e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} të ketë cënuar të drejtat e palëve dhe të viktimave”.

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji Penal/Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka të dhëna për këtë aspekt.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistratja dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese në përmbajtje të dokumenteve ligjore (relacione) të saj gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmës ligjore si edhe gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Po ashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese në komunikimin me kolegët, administratën gjyqësore, gjyqtarët apo subjekte të tjera.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ndihmësmagjistratja.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE PËR HEQJE DORË TË REFUZUARA NGA KRYETARI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat statistikore;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

Në raportin analitik të rivlerësimit dhe aktet për vlerësimin e aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit nga Kolegji nuk ka të dhëna për numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari.

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (*burimet arkivore të KLD/KLGJ*) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për heqjen dorë nga trajtimi i çështjes.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, pavarësisht funksionit që ai ushtron për kohësisht si i komanduar, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat

e Ligjit për Statusin dhe aktet e Skemës së Vlerësimit të dala në bazë të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave për heqje dorë të pranuar nga kryetari, për ndihmësmagjistraten {...} është i pa konsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari në periudhën e vlerësimit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari është i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet “i pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A. AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, nuk ka të dhëna.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të hartuar nga KLGJ citohet ; “Në 6 nga 8 dokumentet ligjore – relacione të ndihmëses ligjore, nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit {...} me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të mënyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore, e qartë, e plotë dhe e saktë.”

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, theksohet se :”Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë, si gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij. Respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar 12 dokumenteve ligjore të hartuara nga ndihmësmagjistratja, rezulton se ajo është shprehur në mënyrë të qartë, transparente, të saktë, koncize dhe drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e shkrimit ligjor.

Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të saj gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar apo me të tretët.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit dhe aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 2 dokumentave ligjorë të përzgjedhur nga subjekti për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short/ 1 të përzgjedhur nga vetë subjekti, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve dhe pjesëmarrësve në proces.

Referuar burimeve të tjera të vlerësimit dhe në tërësi akteve të dosjes së vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna të cilat mund të krijojnë dyshim për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve apo pjesëmarrësve në proces, nga ana e ndihmëses ligjore.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se ndihmësmagjistrata ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga ndihmësmagjistrati dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse, nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore apo me trupën gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Nuk janë konstatuar vonesa në relativimin e çështjes, që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit apo në seancën gjyqësore, kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë gjykatë dhe veprimet e ndihmësit ligjor me dosjet përkatëse, nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e

shpejtësisë dhe të sasisë në punë. Në dy vendimet gjyqësore të deklaruar nga gjyqtarja, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, theksohet se :”*Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjore, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij..”.*

4.B.A. GATISHMËRIA DHE SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, janë edhe vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Në aktet e vlerësimit profesional të ndihmësit ligjor nga Kolegji, aftësia e saj për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me kolegët vlerësohet në nivel shumë të lartë.

Sa më sipër, në mungesë të të dhënave, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, për mungesën e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ka ekzistuar dhe ka qenë në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, vlerësohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me ta.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.B.B GATISHMËRIA DHE KONTRIBUTI PËR TË KRYER DETYRA TË TJERA QË I NGARKOHEN NGA ORGANET DREJTUESE TË GJYKATËS

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, përveç evidentimit të numrit të çështjeve të përgatitura dhe relatuara nga ndihmësi ligjor, evidentohet edhe kontributi i saj në përgatitjen e projektvendimeve gjyqësore penale, duke u evidentuar në këto akte, të dhënat si më: *“..Për periudhën prill 2014- prill 2015 ka relatuar në total 180 çështje penale dhe 40 civile si dhe ka përgatitur projektvendime gjyqësore... sipas ngarkesës së gjyqtarit pranë të cilit ushtron funksionin, gjithësej 50 projekt- vendime.”*, *“...Për periudhën prill 2015- prill 2016 ka relatuar nën total 230 çështje civile si dhe ka përgatitur projekt vendime gjyqësore civile.... sipas ngarkesës së gjyqtarit pranë të cilit ushtron funksionin, gjithësej 62 projekt- vendime.”*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (*gradimin*), një nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungon ndërsa mendimi i kryetarit është pjesë e aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar akteve të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji, rezulton se aftësia e ndihmëses ligjore {...} për të kontribuar në kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara nga organet drejtuese të gjykatës është vlerësuar e lartë, duke renditur edhe detyrat e kryera në këtë drejtim.

Gjithashtu, referuar provave të paraqitura prej gjyqtares, rezulton se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë, ajo ka marrë pjesë si përfaqësueses e këtij institucioni në tryezën e rrumbullakët të zhvilluar në ambjentet e British Council me këshilltarët ligjor të Gjykatës së Lartë, për të diskutuar çështjet e GjEDNJ VS Shqipërië, disa vendime të Gjykatës së Lartë e të Gjykatës Kushtetuese të zhvilluar në dy ditë, në muajin Shkurt 2015.

Në kushtet kur rezulton angazhimi i ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës sikurse është pjesmarrja në këtë aktivitet, si përfaqësueses e Gjykatës së Lartë, veç kontributit të saj në lidhje me trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe kryerjen e detyrave thelbësore të ndihmësit ligjor, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, vlerësohet se aftësia e saj në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të gjykatës”, ndihmësmagjistratja pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton angazhimi dhe kontributi i saj konkret.

4.B.C AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR DHE PËR TË REAGUAR ME EFIKASITET NË RAST NEVOJE

Në raportin analitik të rivlerësimit dhe aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues, por evidentohen dhe vlerësohen maksimalisht aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndihmës ligjore, duke theksuar se :”Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjore, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij..”.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (*gradimin*) një nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungon⁷⁴ ndërsa mendimi i kryetarit është pjesë e aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të vlerësimit.

⁷⁴ Në formularin e vetëvlerësimit të aftësive profesionale të plotësuar nga gjyqtari në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues pasi formulari kryesisht përqëndrohet në pasqyrimin e të dhënave lidhur me veprimtarinë e subjekteve të rivlerësimit dhe jo në vetëvlerësim të tyre sipas një metodologjie të paracaktuar.

Referuar akteve të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji, rezulton se aftësia e ndihmëses ligjore {...} për të krijuar marrëdhënie korrekte me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore si dhe aftësia e saj për të shmangur situata konfliktuale është vlerësuar shumë e lartë.

Referuar burimeve të vlerësimit dhe tërësisë së akteve të dosjes së vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për ekzistencën e situatave të konfliktit apo mënyrës së menaxhimit të tyre, raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës dhe reagimi i saj për zgjidhjen e tyre me efikasitet dhe duke ruajtur qetësinë dhe etikën.

Në kushtet kur nuk ka të dhëna konkrete që mund të cenojnë vlerësimin për aftësinë e ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar dhe reaguar me efikasitet në rast nevojë dhe në të njëjtën kohë, shkalla e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të saj me administratën gjyqësore është vlerësuar maksimalisht nga Kolegji, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues vlerësohet se shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevojë për ndihmësmagjistratën {...} është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA

Lidhur me këtë aspekt në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “...Subjekti i rivlerësimit {...} i ka kushtuar rëndësi formimit akademik... Si subjekt që trajnohet nga Shkolla e Magjistraturës, ajo ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrëse e 15 seminareve trajnuese të organizuar nga kjo shkollë, me gjithsej 27 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale ”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë aspekt, konkludohet se :”Ka marrë dhe merr pjesë aktive në aktivitetet profesionale dhe trajnuese të organizuara nga Sh. M që janë pjesë e trajnimit vazhdues”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIK TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit analitik të rivlerësimit si dhe vërtetimit të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës rezulton se gjyqtarja {...}, ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) në cilësinë e pjesëmarrësit, në 15 aktivitete trajnuese, pjesë e Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluara në periudhën kohore 18.11.2013-02.02.2016, gjithsej 27 ditë trajnimi;
- (ii) në cilësinë e pjesëmarrësit në aktivitete jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, ndihmës magjistratia ka deklaruar se ka marrë pjesë në 5 trajnime të shtrira në 6 ditë. 4 nga 5 trajnimet janë kryer gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016 (10.06.2014 - 13.02.2016) dhe janë shtrirë në 5 ditë por vetëm për një prej tyre ka paraqitur dokumenta shoqëruese.

Sa më sipër, rezulton se Znj. {...}, ka marrë pjesë në 15 aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime, brenda programit të Formimit Vazhdues, të cilat kanë zgjatur në **total 27 ditë**.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka marrë pjesë në 15 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 27 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3⁷⁵, të ligjit nr.96/2015 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pjesëmarrja e ndihmësmagjistratit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e ndihmësmagjistrates në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është më shumë se 15 ditë dhe më pak se 120 ditë në 3 vite dhe pikëzohet me 20 pikë.

⁷⁵ Në nenin 5, pika 3 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se :” 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.”.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E NDIHMËSMAGJISTRATIT PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit analitik të rivlerësimit dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton se Znj. {...} të jetë angazhuar në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë ndihmësmagjistratët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistratën {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësuesit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese apo eksperte.

Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve” ndihmësmagjistratja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

4.C.C PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI NDËRINSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, akteve të vlerësimit të Kolegjit, dosjes personale të gjyqtarës dhe formularit të vetëdeklarimit për aftësitë profesionale nuk rezultojnë të dhëna që Znj. {...}, në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet e plota 2013-2016, të ketë marrë pjesë në aktivitete, të cilat vlerësohen si veprimtari ndërinstitucionale, që kanë pasur si qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fusha të ndryshme të së drejtës.

Gjatë procedurës së vlerësimit, nga ana e magjistrates {...} u paraqitën akte për të provuar përfshirjen e saj në veprimtari ndërinstitucionale. Konkretisht, vërtetimin datë 29.09.2022 si dhe vërtetimin datë 05.10.2022 të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, sipas të cilit rezultojnë se Znj. {...} ka qenë angazhuar si personel akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës pranë Departamentit të së Drejtës Publike, në semestrin e parë të vitit akademik 2013-2014. Ajo ka punuar si pedagoge e jashtme në lëndën “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare” si dhe ka punuar materiale didaktike në bashkëpunim me pedagogët e lëndës⁷⁶.

Gjithashtu, sipas vërtetimit nr. ekstra prot., datë 20.10.2022, lëshuar nga Kryetari i Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë⁷⁷, rezultojnë se Znj. {...} është anëtare e këtij unioni prej vitit 2015 dhe ka marrë pjesë aktive në veprimtari dhe angazhimet e Unionit në kuadër të propozimit të ndryshimeve legislative. Një ndër ligjet që ka punuar është ai “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin ka hartuar sygjerimet përkatëse të Unionit, në lidhje me trajtimin financiar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarën {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë që ndihmësmagjistratja {...} të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë periudhës së vlerësimit.

⁷⁶ Bashkëlidhur vërtetimit janë paraqitur disa materiale didaktike/ leksione, me tema; Zgjidhja gjyqësore e mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare (11 faqe), leksioni Konsiderata të Përgjithshme në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare (6 faqe); Parimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare (15 faqe), materiale të cilat i janë dërguar me e-mail pedagoges tjetër të lëndës, Znj. Sqarri në datë 30.10.2013, datë 27.01.2014.

⁷⁷ Bashkëgjitur vërtetimit është paraqitur propozimi i Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, Bordi Drejtues, drejtuar Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, në lidhje me Projektligjin “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (3 faqe).

Pjesëmarrja, kontributi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i ndihmësmagjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton angazhimi i saj në aktivitete të kësaj natyre.

4.C.Ç PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Sipas formularit të vetë deklaramit⁷⁸ për aftësitë profesionale dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtarit, referohet se gjyqtarja ka publikuar artikullin me temë “Ndryshimi i cilësisë juridik të veprës penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ” dhe artikullin me temë “Gjykimi në mungesë dhe e drejta e ankimit”, në Revistën Juridike nr. 2, qershor 2012, botim i Shkollës së Magjistraturës. Po ashtu referohet se ka botuar artikullin me temë “Trajtime teorike dhe problematika gjyqësore në lidhje me pagimin e padetyruar dhe begatimin pa shkak”, në Revistën Magjistrati V, botim i Shkollës së Magjistraturës, në vitin 2012.

Artikujt e referuar si më sipër, rezulton të jenë botuar në vitin 2012 dhe për pasojë nuk i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka qenë gjatë vazhdimit të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht në vitin e dytë të shkollës dhe vitin e tretë (tetor 2012- Korrik 2013), të kryerjes së shtazhit profesional sipas ligjit Nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar. Megjithëse gjatë kohës së periudhës së stazhit profesional magjistrati gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime si gjyqtar, këto aktivitete/angazhime janë vlerësuar nga Shkolla në përfundim të ciklit të studimit, e si e tillë nuk mund të jenë objekt i periudhës së gradimit, edhe sikur ata t’i përkasin periudhës së vlerësimit (Tetor 2013- Tetor 2016).

Nga dosja personale e gjyqtares dhe të dhënat që administrohen në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna të tjera në drejtim të publikimeve ligjore dhe akademike gjatë periudhës së vlerësimit.

⁷⁸Formulari i vetë deklaramit, faqe 10 dhe faqe 48-52 e në vijim e dosjes së rivlerësimit si dhe kopje e publikimeve dhe dokumenteve bashkëlidhur formularit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për znj. {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë për shkak se nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Angazhimi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i ndihmësmagjistrates dhe për këtë ky tregues ndihmësmagjistratja pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	93

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} NDIHMËSMAGJISTRATE NË GJYKATËN E LARTË NË PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013 - 2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT			Piket total		Niveli i vlerësimit	
			100		Shkëlqyeshëm	
Treguesit		Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore		a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
		b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor		a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë

		përzgjedhura me short);			Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e dokumentit ligjor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi standard	15	Shkalla e aftësisë: Nën standard – 5 pikë Në standard – 10 pikë Mbi standard – 15 pikë
	b. Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	+99%	15	Rendimenti: Nën 81 % - 3 pikë Mbi 81-87 % - 6 pikë Mbi 87- 93 % - 9 pikë Mbi 93-99 % - 12 pikë +99% - 15 pikë

B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara	a. Respektimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të përgatitur për relativim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	20	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve - 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve- 5 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve- 10 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 15 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 20 pikë
C. Metodologjia e punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e	a. Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë: E dobët- 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë

<i>kohës)</i>	organizimit të procesit gjyqësor	vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë - 15 pikë
	b. Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë: E dobët - 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
	c. Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë: E dobët - 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit : E dobët – 0 pikë

					Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të gjykatës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	10	Shkalla e bashkëpunimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4

	b. Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë	• Dosja e rivlerësimit;	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
NIVELI I VLERËSIMIT		SHKËLQYESHËM			
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		393			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR